



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Këshilli i Legjislacionit

PROCESVERBAL

Tiranë, më 03.04.2023, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Këshillit të Legjislacionit

Rendi i ditës:

Relatimi i relatorëve lidhur me shqyrtimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, objekt shqyrtimi nga Këshilli për Legjislacion.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Etilda Gjonaj, Toni Gogu, Dhurata Çupi (Tyli), Gazment Bardhi, Saimir Korreshi dhe Greta Bardeli.

Mungon:

Enkelejd Alibeaj.

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëdita kolegë!

Meqenëse kuorumi për të lejuar vijimin e mbledhjes së Këshillit të Legjislacionit është më shumë se pesë veta, që është edhe kushti që vendos Rregullorja e Kuvendit në nenin 14 të saj, unë e deklaroj të hapur mbledhjen e Këshillit të Legjislacionit.

Sot në rendin e ditës së mbledhjes kemi relatimin për vendimet e Gjykatës Kushtetuese për dy blloqet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nisur nga vendimi nr.30, datë 02.11.2022; vendimi nr.35, datë 22.11.2022; vendimi nr.37, datë 01.12.2022; vendimi nr. 38, datë 9.12.2022 dhe vendimi nr.39, datë 15.12.2022. Këto janë blloku i parë i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Po ashtu, kemi vendimet 1 dhe 2 të Gjykatës Kushtetuese që i përkasin vitit 2023.

Në mbledhjen e fundit relatorë për këto vendime caktuam zotën Toni Gogu, zonjën Etilda Gjonaj dhe zonjën Klotilda Bushka. Me sa jam vënë në dijeni nga stafi që asiston Këshillin e Legjislacionit relatimet nga ana e kolegëve janë gati. Unë ju ftoj ta fillojmë relatimin me radhë duke ndjekur kronologjinë e dhënies së vendimeve nga ana e Gjykatës Kushtetuese.

Kështu, do të ftoj zotën Toni Gogu, që të relatojë për vendimin nr. 30 dhe vendim nr. 35. Pas relatimit ne do të diskutojmë hap pas hapi secilin nga sugjerimet që do të bëjnë relatorët.

Biem dakord që të procedojmë në këtë mënyrë? Kjo më duket mënyra më logjike dhe më e thjeshtë.

Në rregull.

Faleminderit për mirëkuptimin tuaj!

Zoti Gogu, ju jeni relator për vendimin nr. 30, datë 02.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese, një vendim i marrë mbi bazën e kërkesës së Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Tiranë, lidhur me shfuqizimin e një shprehjeje të përdorur në një dispozitë të Kodit të Procedurës Civile. Konkretisht, bëhet fjalë për nenin 511 të Kodit të Procedurës Civile. Sidoqoftë, për më shumë do të na relatoni ju.

Njëkohësisht, ju do të relatoni edhe për vendimin nr. 35 të datës 22.11.2022, vendim i Gjykatës Kushtetuese marrë mbi bazën e kërkesës së Unionit të Gjyqtarëve të Shqipërisë me objekt shfuqizimin e disa pikave në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e

Shqipërisë”, si dhe në ligjin “Për pensionet shtetërore suplementar të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe punonjësve të shtetit”.

Ju lutem, fjala është për ju.

Faleminderit!

Toni Gogu - Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë,

Po filloj me relatimin për vendimin nr. 30 të Gjykatës Kushtetuese, i cili është shpallur më 30.11.2022. Gjykata Kushtetuese, pasi mori në shqyrtim në seancë plenare kërkesën e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me objekt: shfuqizimin e shprehjes “gjykata duhet të parashikojë kamatat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare”, në shkronjën “d”, të paragrafit të pestë, të nenit 511 të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur:

1. Të deklarojë se zbatimi i nenit 511, paragrafi i pestë, shkronja “d”, të Kodit të Procedurës Civile, në shprehjen “që rregullon pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare”, nuk është në përputhje me Kushtetutën në rastet e akteve për dhënie kredie bankare konsumatore.

2. Të detyrojë Kuvendin e Shqipërisë të plotësojë ligjin sipas arsytimit të këtij vendimi brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e vendimit.

Vendimi është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 162/2022.

Për më shumë nga pjesa e arsytimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese ju relatoj si më poshtë:

Gjykata në pjesën arsyetuese të vendimit ka parashtruar shkaqet për të cilat ka vendosur shfuqizimin e nenit 511, paragrafi i pestë, shkronja “d”, të Kodit të Procedurës Civile, për sa i përket shprehjes që citova më sipër. Nga analiza e nenit 511, paragrafi i pestë, shkronja “d”, të Kodit të Procedurës Civile, Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se formulimi i shprehjes “gjykata duhet të parashikojë kamatat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare”, nuk lejon mënyrë tjetër interpretimi përveçse parashikimin e kamatave ligjore për titullin ekzekutiv “akt i dhënies së kredisë bankare” (pra për këta tituj ekzekutivë), sipas rregullave të nenit 5 të ligjit nr. 48/2014. Ky ligj përcakton mënyrën e llogaritjes së kamatëvonesës, duke e zbatuar atë për të gjitha detyrimet ose pagesat, si për ato që

rrjedhin nga kontratat me konsumatorë, ashtu edhe për ato që rrjedhin nga veprimet juridike tregtare.

Neni 2 i ligjit nr. 48/2014 përjashton nga fusha e zbatimit të tij detyrimet ose pagesat që rrjedhin nga kontratat me konsumatorët dhe këtu krijohet gjithë konfondimi. Mirëpo, pavarësisht përmbajtjes së nenit 2 të të njëjtit ligj në rastin e lëshimit të urdhrit të ekzekutimit për titullin ekzekutiv “akt i dhënies së kredisë bankare konsumatore”, gjykata e juridiksionit të zakonshëm, bazuar në nenin 511 të Kodit të Procedurës Civile, është e detyruar të përlllogarisë kamatat tregtare të përcaktuara nga neni 5 i po këtij ligji. Kjo do të thotë se formulimi i dispozitës së kundërshtuar detyron gjykatat që në procedurën e lëshimit të urdhrit të ekzekutimit për tituj ekzekutivë “kontrata bankare të kredisë konsumatore”, që i hap rrugën ekzekutimit të detyrueshëm të tyre, të përlllogarisin kamatat ligjore sipas ligjit nr. 48/2014. Pra, dispozita duket se bën të zbatueshme të njëjtat rregulla ligjore për kamatat me ato për titujt ekzekutivë “kredi bankare” për qëllime të veprimtarisë tregtare, ndonëse këto dy kategori kredimarrësish janë të ndryshëm. Gjithashtu, formulimi i dispozitës së kundërshtuar ia delegon pa përjashtim përlllogaritjen e kamatave ligjore për titujt ekzekutivë “kredi konsumatore” dhe “kredi tregtare” rregullave të ligjit nr. 48/2014, ndonëse ky i fundit shprehimisht përjashton nga fusha e zbatimit të tij detyrimet ose pagesat që rrjedhin nga kontratat me konsumatorët. Në këtë mënyrë, gjykata ka arritur në konkluzionin se dispozita e kundërshtuar nuk përmbush kriterin e parashikueshmërisë së kërkuar nga parimi i sigurisë juridike në rastin e ndërhyrjeve që bën ligjvënësi në të drejtat kushtetuese, përfshirë të drejtën e pronës.

Gjykata, gjithashtu, ka pohuar se parimi i sigurisë juridike, si element i shtetit të së drejtës, ka si kërkesë të domosdoshme që ligji në tërësi ose dispozita të veçanta të tij në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme. Kështu që, gjykata në arsyetimin e vet bën edhe këtë sqarim. Një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i lë shteg zbatuesit t’i japë asaj kuptime të ndryshme dhe që sjell pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma. Gjykata vlerëson se vetë kamata ligjore përbën pronë private, në kuptim të nenit 41 të Kushtetutës dhe se dispozita e kundërshtuar ndërhyr duke e kufizuar këtë të drejtë kushtetuese.

Më tej, gjykata ka deklaruar se zbatimi i nenit 511, paragrafi i pestë, shkronja “d”, e Kodit të Procedurës Civile në shprehjen “*që rregullon pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare*”, nuk është në përputhje me Kushtetutën në rastet e akteve për dhënien e kredisë

konsumatore. Gjykata i kërkon Kuvendit të marrë masat e duhur për të rregulluar në përputhje me parimet dhe standardet kushtetuese mënyrën e përlllogaritjes së kamatave ligjore në rastin e titujve ekzekutivë “kontrata bankare të kredive konsumatore”.

Të nderuar anëtarë të Këshillit, ky vendim është i detyrueshëm për t’u zbatuar nga Kuvendi, referuar edhe përcaktimeve të nenit 132 të Kushtetutës. Ne si Këshilli i Legjislacionit e diskutojmë në cilësinë e organit që Rregullorja e Kuvendit e ka ngarkuar me detyrën për ta analizuar dhe për ta diskutuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe në zbatim të procedurës të caktuar në nenin 87 të Rregullores, pasi kemi kryer të gjitha veprimet procedurale të ngarkuara nga ky nen, po paraqesim një relacion dhe një raport të caktuar, i cili do t’i shkojë më pas komisionit përkatës. Megjithëse vendimi nr. 30/2022 i Gjykatës Kushtetuese nuk hyn në përcaktimet e nenit 87, pika 1 e Rregullores së Kuvendit, marrja në shqyrtim nga ana e Këshillit të Legjislacionit buron si detyrim kushtetues sipas përcaktimit në dispozitivin e këtij vendimi. Prandaj dispozita ka krijuar boshllëkun ligjor në ekzekutimin e titujve ekzekutivë që lidhen me kamatat ligjore me legjislacionin në fuqi që rregullon pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore dhe tregtare.

Për sa më sipër parashtrova, në cilësinë e relatorit të caktuar nga ky Këshill, në zbatim të pikës 5, të nenit 87 të Rregullores së Kuvendit, ku nevojitet marrja e nismës ligjvënëse për plotësimin ose ndryshimet në legjislacion, Këshilli i paraqet rekomandimet e nevojshme komisionit përgjegjës dhe nismëtarit ose ndërmerr vetë nismë ligjvënëse. Atëherë, i propozoj Këshillit dërgimin e rekomandimeve nismëtarit, në rastin konkret Këshillit të Ministrave, për plotësimin e legjislacionit, riformulimin e shkronjës “d”, paragrafi i pestë, të nenit 511 të Kodit të Procedurës Civile.

Ju falënderoj për vëmendjen!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Gogu për relatimin në lidhje me vendimin nr.30/ 2022 të Gjykatës Kushtetuese!

A ka pyetje nga kolegët për relatorin?

Në qoftë se nuk ka pyetje, a ka diskutime në lidhje e sugjerimin që bëri relatori pak më parë?

Zoti Bardhi.

Gazment Bardhi - Faleminderit, zonja kryetare!

Ne biem dakord me propozimin e relatorit që plotësimi i vakumit që është krijuar në nenin 511 të Kodit të Procedurës Civile, t’i kalojë për analizë të mëtejshme Këshillit të Ministrave,

sigurisht për të ndërmarrë iniciativën ligjore nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe që të miratohet nga Kuvendi. Pra, ne biem dakord me sugjerimin që ky vendim, pra rekomandimi përkatës t'i dërgohet Këshillit të Ministrave.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

A ka diskutime të tjera nga kolegët?

Në fakt, edhe unë bie dakord, edhe me relatorin, edhe me atë çka shprehur zoti Bardhi pak më herët. Sigurisht që vendimi nr. 30 i Gjykatës Kushtetuese, është një vendim i iniciuar me kërkesë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk hyn në rrethin e vendimeve për të cilat Rregulloja e detyron Kuvendin e Shqipërisë dhe përkatësisht Këshillin e Legjislacionit që t'i marrë në shqyrtim dhe në analizë, por në dispozitivin e vendimit nr. 30 për të cilin jemi duke diskutuar, në pikën 2 të tij shprehet konkretisht kështu: “Gjykata Kushtetuese vendosi të detyrojë Kuvendin e Shqipërisë të plotësojë ligjin sipas arsyetimit të këtij vendimi brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e vendimit”.

Duke rënë dakord me propozimin e relatorit, që plotësimin e këtij boshllëku ligjor ta bëjë nismëtari, pra Këshilli i Ministrave, unë dua që këtij sugjerimi t'i shtojmë dhe një kujtesë, atë të mbajtjes parasysh të afatit që ka vendosur Gjykata Kushtetuese në vendimin e vet. Meqenëse vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqinë e ligjit, ato botohen në Fletore Zyrtare, si të tilla ato detyrojnë cilindo nga organet qendrore dhe jo vetëm.

Kështu pra, e mbyllim shqyrtimin dhe analizën për vendimin nr. 30 dhe kalojmë në një vendim tjetër, që do të duhet, po ashtu, ta relatojë zoti Gogu, është fjala për vendimin nr.35 të vitit 2022, një vendim që është marrë mbi bazën e kërkesës së Unionit të Gjyqtarëve të Shqipërisë që lidhet me ligjin për statusin e magjistarëve në Republikën e Shqipërisë.

Zoti Gogu, fjala është për ju.

Toni Gogu - Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Legjislacionit, ashtu siç ju e referuat zonja kryetare, Gjykata Kushtetuese ka marrë vendimin nr.35, datë 22.11.2022. Po ashtu, ka shpallur një vendim disa ditë më vonë më 30.12.2022, pasi ka shqyrtuar në seancë plenare kërkesën e Unionit të Gjyqtarëve të Shqipërisë, me objekt shfuqizimin e disa pikave të neneve të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, si dhe të ligjit nr.8097 datë 21.03.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione

kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, edhe ky i ndryshuar. Gjykata ka vendosur, së pari, shfuqizimin e nenit 12, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” me nenin 2, pika 1 të ligjit nr. 50 të vitit 2021, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Së dyti, shfuqizimin e nenit 1, pika 7, paragrafi i dytë, shkronjat “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 8097, datë 21.03.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar me nenin 1, pika 1, të ligjit nr. 166 të vitit 2020, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Vendimi është botuar në Fletoren Zyrtare.

Në lidhje me kushtetueshmërinë e nenit 12, shkronja “a” të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Gjykata Kushtetuese konstaton, se neni 138 si normë kushtetuese përcakton një nga elementet përbërës të statusit të gjyqtarit, pikërisht trajtimin financiar pa të cilin nuk mund të garantohet ushtrimi i pavarur i funksionit të gjyqtarit. Garancitë e kësaj norme të Kushtetutës u njohin gjyqtarëve një trajtim të veçantë jo vetëm në pagë, por edhe në elemente të tjera që burojnë nga ushtrimi i funksionit të tyre. Paprekshmëria e pagës dhe e përfitimeve të tjera janë ngritur në nivel kushtetues, me qëllim që të drejtat apo përfitimet, që burojnë nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit, të mos ndryshohen me efekt negativ. Për këtë ka jurisprudencë të Gjykatës Kushtetuese dhe janë pikërisht dy vendime, vendimi nr. 78, datë 12.12.2017 dhe vendimi nr. 34, datë 10.04.2017.

Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese konstaton se duke vlerësuar hartimin dhe miratimin e ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndër të tjera dhe rishikimin e sistemit të pagave, përfitimeve dhe shpërblimeve të tjera të magjistratit, me qëllim përmirësimin e trajtimit të tyre në përputhje me përvojën në punë, zhvillimin e karrierës dhe vështirësive, gjykata ka vlerësuar se në referim të legjislacionit të kohës për nëpunësin civil, neni 12 të ligjit 96/2016, ka përcaktuar qartë dhe mjaftueshëm elementet e pagës mujore bruto (në rastin konkret të magjistratëve) dhe në veçanti elementin “pagë referuese bazë”. Konkretisht, kjo dispozitë ka përcaktuar se paga referuese bazë është e njëjtë me pagën për funksion të nëpunësve civilë të nivelit më të lartë drejtues të shprehur në konceptin e kategorisë së parë, klasa e tretë, ku sipas ligjit “Për nëpunësin civil” përfshihet pozicioni i punës “Drejtor i drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri” ose çdo pozicion i barasvlershëm me të.

Fakti se VKM-ja e pagave nuk përmbante klasë të tretë të kategorisë së parë, nuk përbën argument për paqartësi ose boshllëk të nenit 12, pika 5, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016 në formulimin fillestar”, konstaton Gjykata Kushtetuese.

Kështu që VKM-ja nr. 187/2017, në bazë të së cilës u bë edhe përlllogaritja e pagës referuese bazë, sipas klasifikimit të këtij akti nënligjor, në pjesën arsyetuese të vendimit Gjykata Kushtetuese analizon se “Ndryshimi që i është bërë me ligjin nr. 50/2021 nenit 12, pika 5, shkronja “a” të ligjit nr. 96/2016 ka arritur në konkluzionin që ky ndryshim ka sjellë rezultat në terma financiarë më të ulët se ai që magjistratët do të përfitonin nga zbatimi korrekt i normës origjinale”. Pra, sipas përmbajtjes së tekstit të saj dhe vullnetit objektiv të treguar nga ligjvënësi në kohën e miratimit të kësaj norme, për herë të parë kemi efekt negativ financiar. Për rrjedhojë, formulimi aktual i normës ligjore, objekt i këtij gjykimi kushtetues, edhe pse synimi i ligjvënësit është qartësimi i përmbajtjes së saj, në fakt, ka sjellë ndryshim të dukshëm të kësaj përmbajtjeje, me pasojë uljen në vlerë të pagës referuese bazë e, në këtë kuptim, uljen e pagës bruto mujore të magjistratit.

Duke krahasuar formulimet ligjore në përmbajtjen kontekstuale të tyre, gjykata, me vendimin nr. 35 të vitit 2022, ka konstatuar se “ato mbartin diferenca të dukshme në referencat e bëra në drejtim të përcaktimit të elementeve të pagës bruto mujore të magjistratit dhe në veçanti të pagës referuese bazë”.

Kështu që në lidhje me kushtetutshmërinë e nenit 1, pika 7, paragrafi 2, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, po të kalojmë te ligji tjetër, tek ai i pensioneve suplementare, Gjykata Kushtetuese në pjesën e arsytimit të vendimit konstaton se “Pensioni shtetëror suplementar është një nga përfitimet e tjera të magjistratit që përfshihet në fushën e mbrojtjes së nenit 138 të Kushtetutës.

Për pensionet suplementare, ashtu si edhe për pagat, standardi i paprekshmërisë së tyre është ngritur në nivel kushtetues, duke qenë kjo një çështje e rregulluar drejtpërdrejt nga ky nen, i cili ka parashikuar në mënyrë shteruese rastet kur është e lejueshme të ndërhyhet në to”.

Gjykata në arsytimin e saj ka krahasuar edhe përmbajtjen e dispozitës së shfuqizuar në momentin e miratimit të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”, duke konkluduar se “Në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016, pika 7 e nenit 1 kishte këtë përmbajtje: “Me termin “pagë referuese” do të kuptohet paga e muajit më të fundit, sipas legjislacionit në fuqi, që zbatohet për atë funksion apo detyrë.

Paga referuese është bazë e llogaritjes së pensioneve suplementare dhe pagës kalimtare”.

Në nenin 1, pika 1, të ligjit nr. 166/2020, paragrafi i dytë u ndryshua si vijon: “Për funksionet e parashikuara të referuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, si dhe për funksionet paga e të cilave referohet te ligji i sipërcituar, me termin “pagë referuese” kuptohet: a) për personat të cilët kanë vite shërbimi deri më 31.12.2018, pavarësisht datës së lindjes së të drejtës për përfitim; b) për personat të cilët kanë vite shërbimi pas datës 1.01.2019 dhe c) për personat të cilët kanë vite shërbimi para dhe pas datës 31.12.2018. Respektivisht sipas përcaktimeve në shkronjat “a” dhe “b” me shumën e muajve, që njihen si periudhë shërbimi për të gjitha funksionet dhe detyrat, por në asnjë rast kjo pagë referuese nuk e tejkalon pagën e Presidentit të Republikës”. Pra, paga referuese është bazë e llogaritjes së pensioneve suplementare dhe e pagesës kalimtare, por pa e kaluar atë të Presidentit të Republikës.

Kështu, magjistratët, subjekte përfituese, janë ndarë në tri kategori: ata që kanë vite shërbimi deri në datën 31.12.2018, ata që kanë vite shërbimi pas datës 1.01.2019 dhe ata që kanë vite shërbimi para dhe pas datës 31.12.2018.

Më tej, për secilën nga këto kategori ligji ka përcaktuar një kuptim dhe zbatim të ndryshëm të pagës referuese, për rrjedhojë një llogaritje të ndryshme të masës së përfitimit.

Më në detaje, për kategorinë e parë, pavarësisht datës së lindjes së të drejtës për përfitim, me “pagë referuese” kuptohet paga e muajit të fundit që zbatohet për atë funksion ose detyrë sipas legjislacionit në fuqi deri më 31.12.2018. Pra, ndryshe nga rregulli i përgjithshëm, që ka qenë në fuqi në kohën e miratimit të ligjit nr. 96/2016 dhe vijon të jetë ende në fuqi, sipas të cilit me “pagë referuese” do të kuptohet paga e muajit më të fundit, sipas legjislacionit në fuqi, që zbatohet për atë funksion ose detyrë, për këtë kategori magjistratësh, paga referuese kufizohet me pagën deri në datën 31.12.2018, ndërsa e drejta për përfitim të pensionit suplementar lind pas kësaj date. Paga referuese e kufizuar me pagën e asaj periudhe rezulton të jetë më e ulët.

Për kategorinë e dytë, me “pagë referuese” kuptohet paga e muajit të fundit që zbatohet për atë funksion sipas legjislacionit në fuqi. Por edhe në këtë rast, ndryshe nga rregulli i përgjithshëm për këtë kategori magjistratësh, paga referuese kufizohet me pagën e Presidentit të Republikës, pagë kjo që rezulton të jetë më e ulët.

Për kategorinë e tretë, me “pagë referuese” kuptohet paga mesatare mujore referuese, që llogaritet si raporti shumës i pagave referuese të të gjitha funksioneve dhe detyrave që kanë gëzuar personat, respektivisht sipas përcaktimeve të shkronjave “a” dhe “b” me shumën e muajve, që njihet si periudhë shërbimi për të gjitha funksionet dhe detyrat, por në asnjë rast kjo pagë referuese

nuk e tejkalon pagën e Presidentit. Pra, edhe për këtë kategori, ndryshe nga rregulli i përgjithshëm, paga referuese jo vetëm nuk llogaritet sipas muajit të fundit që zbatohet për atë funksion, sipas legjislacionit në fuqi në momentin e lindjes së të drejtës për përfitim, por edhe kufizohet me pagën e Presidentit, çka bën që paga referuese për këtë kategori magjistratësh të rezultojë më e ulët.

Nga ana tjetër, në shkronjat “b” dhe “c” të pikës 7 të nenit 1, është vendosur një tavan përfitimi, që referon te paga e Presidentit, kufizim ky që shkon përtej kufijve dhe vlerave maksimale të përfitimit që ka vendosur vetë ligji për të gjitha subjektet përfituese ndaj të cilave zbatohet. Pra, Gjykata vëren se “Në kushtet kur paga e magjistratit është rritur dukshëm, krahasuar me kategoritë e tjera të pagave të funksionarëve publikë, edhe masa e kontributeve të këtyre subjekteve është në raport me këtë nivel të ri page. Për rrjedhojë, vendosja e një mase përfitimi tavan, bazuar në një pagë që nuk përputhet me nivelin e pagës së magjistratit, automatikisht prek masën e pensionit suplementar, duke e ulur atë”.

Në përfundim, nga analiza e pjesës arsyetuese dhe dispozitivit të vendimit nr. 35/2022 të Gjykatës Kushtetuese, ndryshimet e bëra nga ligjvënësi me ligjin nr. 50/2021, neni 12, pika 5 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, si dhe ligjin nr. 8097, datë 21.03.1996 “Për pensionet shtetërore”, i ndryshuar”, neni 1, pika 1, konsiderohen si ndryshime që kanë ulur nivelin e pagës së magjistratëve dhe përfitimet e tjera të tyre, pra pensioneve suplementare, duke cenuar parashikimet e nenit 138 të Kushtetutës.

Ndaj, të nderuar anëtarë të Këshillit të Legjislacionit, në zbatim të të gjitha rregullimeve të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit për veprimtarinë e këtij Këshilli, ku vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe pjesa arsyetuese e tyre janë të zbatueshme për ne, në cilësinë e relatorit i propozoj Këshillit të Legjislacionit, pra juve, dërgimin e rekomandimeve në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, specifikisht në një grup pune të ngritur në zbatim të rregullimit të propozimeve që janë paraqitur për ndryshime në ligjet specifike, të cilat Gjykata Kushtetuese sapo ka shfuqizuar paragrafët e mësipërm.

Kështu, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në riformulimin e dispozitave të shfuqizuara nga Gjykata Kushtetuese, duhet të marrë opinione patjetër nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nga Departamenti i Administratës Publike dhe nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, si dhe duhet të harmonizojë dispozitat e riformuluara me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi, me qëllim gjetjen e një formule, e cila të mos ulë pagën e

magjistratit dhe as përfitimet e tjera të tyre, të fituara në momentin e miratimit të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Faleminderit për vëmendjen!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Gogu, edhe për këtë relativitet të hollësishëm!

Në të njëjtën mënyrë, ka pyetje ose diskutime nga kolegët? Po, zoti Bardhi.

Gazment Bardhi – Jo, nuk kam gjë për të shtuar. Sigurisht, ishte edhe sugjerim imi i herës së kaluar.

Thjesht dua të informoj Këshillin që grupi i punës, që kolegu Gogu përmendi dhe ku ne të dy jemi anëtarë, është ngritur dhe është funksional. Ekspertët kanë punuar një draft në bashkëpunim me të gjitha institucionet që përmendi kolegu, përfshirë Ministrinë e Financave, dhe besoj se shumë shpejt do t’u paraqitet për opinion edhe kolegëve anëtarë të Komisionit të Ligjeve, para se iniciativa të merret në mënyrë zyrtare për miratimin e ndryshimeve në zbatim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Kështu, biem dakord me sugjerimin e relatorit që ky vendim t’i kalojë këtij grupi pune pranë Komisionit të Ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Mendoj se jemi korrektë edhe me sugjerimin që bëri relatori, edhe me mbështetjen që vjen nga ana e përfaqësuesve të pakicës në këtë Këshill Legjislativ. Pra, punën do të duhet ta vazhdojë më tej Komisioni i Ligjeve, qoftë edhe për faktin se Kuvendi ka qenë nismëtar i reformës në drejtësi dhe ligji kryesor për të cilin bën fjalë vendimi nr. 35/2022 është një nga ligjet e reformës në drejtësi, pra ai që ka të bëjë me statusin e magjistratit, një status të cilit ne i kemi bashkëngjitur edhe standardin e paprekshmërisë kur vjen fjala të paga dhe përfitimet e tjera.

Sa për kujtesë, meqenëse kjo mbledhje ndiqen *live* dhe, sigurisht, besoj që në rastin e këtij vendimi interesi është i shtuar, unë desha të vë në dukje edhe faktin që Komisionit të Ligjeve, duke marrë shkas nga ky vendim, i janë drejtuar edhe organet e rivlerësimit ose organet e vetingut. Sakaq, kam përpara shkresën me nr. Prot 468, datë 6.2.2023, që Kuvendit të Shqipërisë i është përcjellë nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, më tej kam shkresën me nr. Prot 1012, datë 26.1.2023 të Komisionerëve Publikë që, po ashtu, i drejtohen Kuvendit të Shqipërisë, si dhe shkresën me nr. Prot 179/1, datë 9.2.2023 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Të gjitha këto organe ngrenë pretendimin se ato përfitojnë ndryshime në pagë për shkak të vendimit nr. 35 të Gjykatës Kushtetuese, njësoj si edhe të gjithë magjistratët.

Kështu, meqenëse për të njëjtën çështje i është kërkuar, po ashtu, reflektim Komisionit të Ligjeve, unë besoj që ka qenë rruga më e arsyeshme që Komisioni i Ligjeve ka vendosur të ngrëjë një grup pune, atë që përmendi pak më parë zoti Bardhi, i cili të punojë për të reflektuar të gjithë pjesën arsyetuese të vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Besoj se biem dakord me të gjithë kolegët që puna do të vijojë në Komisionin e Ligjeve nga grupi i posaçëm i ngritur brenda tij.

Faleminderit, zoti Gogu!

Kalojmë në një relativitet tjetër, në fakt, dhe kësaj here do të duhet të kemi ndihmën e koleges sonë, zonjës Etilda Gjonaj, së cilës i është ngarkuar relativiteti për dy vendime të tjera të Gjykatës Kushtetuese, atij nr. 37, të marrë mbi bazën e kërkesës së Dhomës së Avokatisë dhe që ka të bëjë me një shfuqizim në ligjin “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, dhe atij nr. 38, datë 9.12.2022, që ka të bëjë me një formulim të Kodit Zgjedhor në nenin 184 të tij,

Po ashtu, do të kemi tre relativitete nga ana e zonjës Gjonaj lidhur me vendimin nr. 39, që lidhet me një iniciativë të një deputeti të Kuvendit të Shqipërisë në Kodin Penal dhe për të cilin Gjykata Kushtetuese ka mbajtur një vendim të saj.

Po ia kaloj fjalën relatores, e cila do të raportojë për secilin nga vendimet dhe Këshilli të mund të marrë vendim.

Faleminderit!

Fjala për ju, zonja Gjonaj.

Etilda Gjonaj – Faleminderit, zonja kryesuese e Këshillit të Legjislacionit!

Të nderuar anëtarë,

Do të tentoj të flas shkurt, për sa të mundem, për secilin relativitet, por aty ku ka interes për t’u ndjekur edhe nga grupet e interesit në zbardhje të vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe asaj çfarë ne mendojmë si Këshilli Legjislacioni do të më duhet të jem e detajuar dhe shteruese.

Ashtu siç jemi vënë në dijeni edhe gjatë mbledhjes së fundit të Këshillit të Legjislacionit, Gjykata Kushtetuese, nëpërmjet vendimit të saj nr. 38, datë 9.12.2022, ka konstatuar se formulimi i nenit 184 të Kodit Zgjedhor, i miratuar me ligjin nr. 101/2020, nuk plotëson kërkesat e nenit 118 të Kushtetutës, duke cenuar kështu realizimin e ushtrimit të së drejtës kushtetuese për të votuar të zgjedhësve me vendbanim të përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në zgjedhjet e datës 25.4.2021 për Kuvendin e Shqipërisë apo asaj që ne e njohim si “vota e diasporës”.

Në arsyetimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese konstatohet se, nëpërmjet ndryshimeve të bëra në Kodin Zgjedhor me ligjin nr. 101/2020, të cilat kanë hyrë në fuqi më 19.08.2020,

ligjvënësi ka synuar realizimin e ushtrimit të së drejtës për të votuar në zgjedhjet për Kuvendin për zgjedhësit me vendbanim të përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilët plotësonin kërkesat e nenit 24, pika 1, përmes votimit të tyre edhe nga jashtë vendit.

Procesi për përgatitjen e kushteve dhe zbatimin e masave që do të mundësonin këtë mënyrë votimi do të bëhej nën udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e KQZ-së, ndërsa votimi nga jashtë vendit do të organizohej dhe do të administrohej nga kjo e fundit në të gjithë komponentët e tij, vetëm pasi Komisioni Rregullator të miratonte të gjitha aktet nënligjore që kërkohen për votimin nga jashtë vendit sipas këtij ligji.

Ndërkohë, në dispozitat e fundit dhe kalimtare të Kodit Zgjedhor, pikërisht në nenin 184 të tij, ligjvënësi ka parashikuar se për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e tij, ngarkohet KQZ-ja.

Ndërkohë, Komisioni Rregullator, po sipas këtij ligji është ngritur dhe ka filluar funksionimin pas datës 7.10.2020 me zgjedhjen e anëtarëve të tij nga Kuvendi.

Pavarësisht ekzistencës së këtyre parashikimeve ligjore deri në zgjedhjet për Kuvendin, të zhvilluara në datën 25.4.2021, rregullatori nuk i miratoi rregullat për regjistrimin e votuesve nga jashtë vendit për procedurat e tyre të votimit, për administrimin dhe numërimin e votave nga jashtë vendit, si dhe për përfshirjen e tyre në rezultatin e përgjithshëm të zgjedhjeve për Kuvendin.

Po kështu, deri në këto zgjedhje rregullatori nuk miratoi zhvillimin për herë të parë të votimit nga jashtë vendit, ashtu sikundër edhe Komisioni Shtetëror për Zgjedhjet nuk arriti të plotësojë masat tekniko-organizative që mundësonin votimin nga jashtë vendit.

“Kodi Zgjedhor, - thekson Gjykata Kushtetuese, - megjithëse krijoi pritshmëri të ligjshme për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë vendit, që do të ushtronin të drejtën e votës për Kuvendin, në fakt, nuk parashikoi qartësisht dispozitat ligjore lidhur me kohën kur organi i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve duhet të mundësonte votimin nga jashtë vendit për këtë kategori zgjedhësish.

Parashikimi i bërë në nenin 184 të këtij kodi për sa i përket nxjerrjes së akteve nënligjore në zbatim të tij është formuluar në mënyrë të përgjithshme, pasi u referohet të gjitha akteve nënligjore që duhet të nxjerrë KQZ-ja në zbatim të Kodit, duke mos specifikuar si objekt rregullimi me akt nënligjor çështjen e votimit nga jashtë vendit dhe organin kompetent për nxjerrjen e tij, si dhe duke mos përcaktuar as afatit brenda të cilit organi duhet të nxjerrë aktin për këtë çështje.

Bazuar në këto konstatime, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se formulimi i nenit 184 të Kodit Zgjedhor nuk plotëson kërkesat e nenit 118 të Kushtetutës, i cili përcakton se aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë dhe se ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të së cilave nxirren këto akte. Kjo paqartësi e normës, jo vetëm cenon parimin e sigurisë juridike, por, në fakt, përbën një boshllëk ligjor që cenon të drejtën kushtetuese të votës së kësaj kategorie, e cila, për shkak të këtij boshllëku, ka mbetur thjesht një parashikim deklarativ, i pazbatueshëm efektivisht në praktikë, duke mbetur në thelbin e saj iluzive.

Është detyrim i Kuvendit të plotësojë boshllëkun ligjor të lartpërmendur brenda një afati, që në rastin konkret konsiderohet të caktohet një vit nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Me konstatimin e ekzistencës së këtij boshllëku ligjor nga Gjykata Kushtetuese, Kuvendi është i detyruar ta plotësojë atë brenda afatit të përcaktuar në vendimin sa më sipër. Ky detyrim që i vendoset Kuvendit nëpërmjet vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 38, datë 9.12.2022 është i detyrueshëm për t'u zbatuar prej tij referuar edhe përcaktimeve të nenit 132 të Kushtetutës, sipas të cilit vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim nga të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike dhe gjykatat.

Për sa më sipër, në respektim të detyrimit të Kuvendit, që rrjedh nga përcaktimi kushtetues që sapo referova, dhe në përmbushje të detyrave që neni 87 i Rregullores së Kuvendit i ngarkon Këshillit të Legjislacionit, në cilësinë e relatores së caktuar nga ky këshill për shqyrtimin e këtij vendimi dhe bazuar në përcaktimin e pikës 5 të këtij neni, propozoj që vendimi nr. 38, datë 9.12.2022 i Gjykatës Kushtetuese t'i kalojë për trajtim Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore, i cili, siç dihet tashmë, vijon funksionin e tij me objekt pune hartimin e ndryshimeve legislative për reformën zgjedhore, në veçanti për trajtimin e rekomandimeve dhe raporteve të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet e 25 prillit 2021, por edhe për zgjedhjet e mëparshme për ato rekomandime të pa trajtuara, si dhe trajtimin e vendimeve nr. 28/2021 dhe nr. 31/2021 të Gjykatës Kushtetuese, të cilat Këshilli i Legjislacionit ia ka kaluar më herët për trajtim këtij komisioni.

E dyta, i sugjeroj Këshillit të Legjislacionit që t'i rekomandojmë Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore të ndërmarrë nismën ligjore për plotësimin e nenit 184 të Kodit Zgjedhor, me qëllim që të eliminohet çdo paqartësi apo papajtueshmëri midis frymës së ligjit dhe zbatimit të tij në praktikë. Hartimi i kësaj dispozite të parashikojë, jo vetëm dhënien e autorizimit për nxjerrjen e akteve nënligjore lidhur me rregullat për regjistrimin e votuesve nga jashtë vendit, për procedurat

e tyre të votimit, për administrimin dhe numërimin e votave nga jashtë vendit dhe përfshirjen e tyre në rezultatin e përgjithshëm të zgjedhjeve për Kuvendin, për caktimin e organit kompetent dhe parimeve në bazë të të cilave nxirren këto akte, por njëkohësisht edhe afatin brenda të cilit duhet të nxirren të gjitha aktet e lartpërmendura.

Për këto arsye, do të kërkoja nga të gjithë anëtarët e Këshillit që ta miratonin këtë sugjerim timin lidhur me një vendim të Gjykatës Kushtetuese, për sa kohë që kemi një komision të posaçëm përgjegjës që trajton të gjitha rastet e reformës zgjedhore dhe për të respektuar atë që të gjithë ne e kemi merak, votën e diasporës.

Kjo ishte për vendimin nr.38 të gjykatës.

Ermonela Felaj – Dakord.

Meqenëse po vendosim rast pas rasti, kolegë, jeni dakord me sugjerimin e relatores?

Po, zoti Bardhi.

Gazment Bardhi – Po, jemi dakord me sugjerimin që ky vendim i Gjykatës Kushtetuese të dërgohet pranë Komisionit të Posaçëm të Reformës Zgjedhore, i cili është duke marrë në trajtim, si një nga pikat e planit të tij të punës, edhe garantimin e votës për shtetasit shqiptarë me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Besoj se jemi të gjithë dakord, edhe për faktin që pesë prej nesh këtu janë anëtarë të Komisionit të Posaçëm për Reformës Zgjedhore. Natyrisht, do të duhet që në atë komision të kemi parasysh edhe afatin 1-vjeçar që ka vendosur Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj.

Vijoni me relatimin e pikës tjetër, zonja Gjonaj.

Etilda Gjonaj - Për sa i përket vendimit nr. 37, datë 1.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese lidhur me një kërkesë të Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese ka vendosur pranimin e kërkesës dhe, gjithashtu, ka kërkuar shfuqizimin e fjalisë së dytë në pikën 8 të nenit 10 të ligjit nr.32/2021, datë 16.03.2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Bazuar në arsyetimin dhe vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 37, mund të theksoj disa nga çështjet kryesore që kjo gjykatë ka trajtuar. E para, lidhet me vlerësimin se liria e veprimtarisë ekonomike nënkupton kryesisht të drejtën për të lidhur kontrata individualisht ose kolektivisht lirisht dhe mbi bazën e vullnetit personal, të drejtën për të zgjedhur aktivitetin që dëshiron të ushtrojë individi dhe të drejtën për të zgjedhur një punë sipas preferencës së tij.

Në vendimin e saj Gjykata Kushtetuese thekson se në thelb, neni 10, pika 8, fjalia e dytë, i këtij ligji rregullon mënyrën e shpërblimit të avokatit, duke përcaktuar vlerat minimale dhe maksimale për shërbimet që ai ofron në procedurat e dëmshpërblimit nga pasojat e aksidenteve. Në këtë mënyrë është e qartë që ligjvënësi me këtë dispozitë ka vendosur kufizim në lirinë kontraktore të avokatit në ofrimin e shërbimeve në këtë fushë specifike. Në rastin konkret ballafaqohet detyrimi kushtetues për të respektuar lirinë e veprimtarisë ekonomike të avokatëve në kuptim të lirisë për të lidhur kontratat e shërbimit sipas tarifave që ata vlerësojnë nga njëra anë me interesat e shtetit për miratimin e rregullave për dëmshpërblimin nga pasoja e aksidenteve, pjesë e të cilave janë edhe procedurat me pjesëmarrjen e avokatit, me qëllim kompensimin e drejtë të subjekteve përfituese nga ana tjetër.

Gjykata ka arsyetuar, gjithashtu, se argumentet për ligjin e masës 5% që janë paraqitur nga subjektet e interesuara u referohen në përgjithësi praktikave abuzive të mbrojtësve, por pa u mbështetur në tregun domethënës të tyre në kuptimin se sa raste të tilla janë raportuar në strukturat mbikëqyrëse të veprimtarisë së avokatëve dhe cilat janë masat e marra në këtë drejtim. Në këtë pikë gjykata evidenton se neni 10 i ligjit nr. 32/2021, ndër të tjera, parashikon se ekzekutimi i vlerës së dëmshpërblimit që rrjedh nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm dhe deklarimi formal i pranimit të vlerës nga pala e dëmtuar apo përfituese shuan përfundimisht detyrimin e shoqërisë së sigurimit. Pala përfituese e dëmshpërblimit nuk ka të drejtë të kërkojë vlerë tjetër dëmshpërblimi të ndryshme nga ajo çfarë ka pranuar me vullnet të lirë nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjes dhe/ose deklaratës së pranimit të vlerës.

Nga analiza e përmbajtjes së ligjit nr. 32/2021, gjykata ka konstatuar se ligji nuk parashikon mbrojtje të detyrueshme për individët që aplikojnë në këto procedura dhe as nuk parashikon që shpërblimi i avokatit është pjesë e shumës së dëmshpërblimit që paguhet nga shoqëritë e sigurimit drejtpërdrejtë të mbrojtësi. Shpërblimi i avokatit në këto raste, thotë Gjykata, është tarifë për shërbimin e ofruar prej tij në çështjet që lidhen me fushën e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit.

Në thelb, përcaktimi i pagesës për avokatin deri në 5% të masës së dëmshpërblimit nuk rezulton të jetë i vetmi mjet i arsyeshëm nëpërmjet të cilit ligjvënësi të realizojë objektivin e tij, pra, për të parandaluar abuzimin me tarifatat e avokatëve në raport me përfituesit e këtij dëmshpërblimi.

Gjithashtu, gjykata konstaton se ligji nr. 32/2021 ka gjetur një mënyrë tjetër të caktimit të shpërblimit të avokatëve, duke vendosur masën tavan në ndryshim nga mënyrat e përcaktuara nga ligji i posaçëm nr. 55/2018, pavarësisht se ky i fundit është miratuar më herët në kohë se ligji nr. 32/2021 që është objekt kundërshtimi.

Për sa më lart, gjykata vlerëson se dispozita e kundërshtuar ndërhyt në lirinë ekonomike në aspektin e lirisë kontraktore të avokatëve, që garantohet nga neni 11 i Kushtetutës dhe, ndonëse ndërhyrja është bërë me ligj dhe për interes publik, në gjykim nuk rezultoi që ajo të respektonte parimin e proporcionalitetit siç kërkon neni 17 i Kushtetutës.

Të gjendur në këtë pikë, të nderuar anëtarë të Këshillit, dhe duke e konsideruar që është një vendim i detyrueshëm për t'u zbatuar nga Kuvendi, por njëkohësisht edhe referuar përcaktimeve të nenit 132 të Kushtetutës, sipas të cilës vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme, edhe në analizën që është bërë, të cilën po e relatojmë, për të arritur në përfundimin se shfuqizimi i kësaj dispozite sjell vakum në ligjin nr. 32/2021 apo plotësimi i legjislacionit në këtë ligj nuk është i nevojshëm për sa kohë që funksioni i avokatit dhe mënyra e shpërblimit të tij është përcaktuar në ligjin nr. 55/2018, kërkohet një analizë me grupet e interesit, siç janë Shoqatat e Siguruesve të Shqipërisë dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

Bazuar në një analizë të formulës së dëmshpërblimit të dëmtuarit nga aksidentet me mjete motorike dhe dispozitave të ligjit për profesionin e avokatisë, mund të vendoset caktimi i një mase në përqindje më të lartë se ajo që është e parashikuar në dispozitën e shfuqizuar apo zbatimin edhe në këto raste të nenit 16 sipas ligjit nr.55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”. Këshilli i Legjislacionit, duke e diskutuar këtë në cilësinë e organit që vetë Rregullorja e Kuvendit e ka ngarkuar me detyrën për të analizuar dhe diskutuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese, konstaton, gjithashtu, se ky ligj është një nismë e Këshillit të Ministrave. Duke mbajtur në konsideratë të gjithë praktikën e deritanishme të Këshillit të Legjislacionit, në cilësinë e relatores të caktuar nga ky këshill për shqyrtimin e këtij vendimi i propozoj Këshillit të Legjislacionit dërgimin e rekomandimit Këshillit të Ministrave për plotësimin e legjislacionit për sigurimin e detyrueshëm në sektorin publik, duke mbajtur në konsideratë edhe arsyetimin e Gjykatës Kushtetuese në vendimit nr. 37/2022, pasi kjo do t'i jepte mundësinë edhe Këshillit të Ministrave të kryente edhe një herë procesin analitik dhe dëgjesat me grupet e interesit, siç është Dhoma e Avokatisë dhe Shoqata e Siguruesve të Shqipërisë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zonja Gjonaj!

Ka diskutime nga kolegët?

Gazment Bardhi - Jo, nuk kemi diskutime. Edhe ne jemi dakord t'i kalojë Këshillit të Ministrave.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Bardhi!

Besoj se është e qartë. Ligji nr. 55/2018, “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë” në nenin 16 të tij e ka përcaktuar shprehimisht se ka disa mënyra për të përcaktuar shpërblimin e avokatëve. Pra, kjo mund të ndodhë me marrëveshje midis avokatit dhe klientit, në përputhje me parashikimin e legjislacionit për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, në përputhje me udhëzimin e përbashkët të ministrave përgjegjës pasi të jetë marrë paraprakisht mendimi i Dhomës Kombëtare të Avokatisë (unë besoj se Këshilli i Ministrave, padyshim, është në pozita më të favorshme sesa Kuvendi në drejtim të adresimit të kësaj gjëje), me tarifë suksesi që përcaktohet në një marrëveshje paraprake midis avokatit dhe klientit dhe natyrisht duke marrë në konsideratë edhe çdo shpërblim tjetër që parashikohet në akte apo praktika të organizmave ndërkombëtare ku Shqipëria aderon. Deri në momentin që Këshilli i Ministrave do të ofrojë një nismë tjetër do të veprohet sipas këtij ligji.

Atëherë jemi dakord edhe për vendim nr. 37/202.

Kalojmë në vendimin nr. 39, 15.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese, i cili është marrë pas shqyrtimit të kërkesës të Komitetit Shqiptar të Helsinkit.

Fjala për ju, zonja Gjonaj.

Etilda Gjonaj - Faleminderit, zonja kryetare!

Bëhet fjalë për shfuqizimin e paragrafit të dytë dhe të tretë të nenit 89, germa “b”, të Kodit Penal pas shqyrtimit të kërkesës së Komitetit Shqiptar të Helsinkit. Ndryshimet në nenin 89, germa “b” të Kodit Penal kanë qenë nismë e disa deputetëve dhe janë miratuar nga Kuvendi me ligjin nr. 35/2020. Në arsyetimin e këtij vendimi, Gjykata Kushtetuese, e cila ka arritur në këtë konkluzion, ka konstatuar se neni 89, germa “b” i Kodit Penal, që lidhet me përhapjen e sëmundjeve infektive, parashikon se përhapja me dashje të sëmundjes infektive me rrezikshmëri të lartë për shëndetin nëpërmjet kryerjes së veprimeve apo mosveprimeve nga personi që është diagnostikuar si mbartës i sëmundjes apo nga personi që ka qëllim përhapjen e saj, dënohet me burgim nga 2-5 vjet; kur është kryer nga pakujdesia dënohet me gjobë ose burgim deri në 2 vjet, kur ka shkaktuar pasoja të rënda për shëndetin ose rrezik për jetën të njerëzve dënohen me burgim nga 3-8 vjet. Duhet të keni

parasysh që ky nen është miratuar në kohën e pandemisë, kur një sërë vendesh ndryshuan legjislacionin e tyre nëse përhapjen e sëmundjeve nuk e kishin parashikuar si vepër penale në Kodin Penal.

Pavarësisht kësaj, në çdo rast, për sa kohë që Gjykata Kushtetuese ka paraqitur argumentet e saj në shfuqizimin që u ka bërë paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 89, germa “b” të Kodit Penal, Kuvendi është i detyruar për ta zbatuar.

Unë dua të sjell disa nga konstatimet që Gjykata ka vlerësuar në vendimin e saj.

Paragrafi 2 dhe 3, të nenit 89, germa “b”, të Kodit Penal, për shkak të paqartësive në formulim nuk plotësojnë aspektin substancial të kriterit kushtetues (nenit 17 të Kushtetutës), ku theksohet se kufizimi vendoset vetëm me ligj. Duke mbajtur në konsideratë që mosplotësimi edhe vetëm i një kriteri e bën ligjin të papajtueshëm me Kushtetutën, gjykata vlerëson të mos analizojë më tej kriteret e tjera për këta dy paragrafë. Në thelb, masat penalizuese nëpërmjet dënimit me burgim për shkak të thyerjes së rregullave të nxjerra gjatë periudhës së një pandemie lidhen në mënyrë të arsyeshme me objektivin e ligjvënësit për të parandaluar dhe ndëshkuar sjelljet e individit që vënë në rrezik shëndetin dhe jetën e njerëzve nga sëmundjet infektive ose rendin dhe sigurinë publike gjatë gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme apo gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

Pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë personale nga mosrespektimi i kriterit të nenit 17 të Kushtetutës, është i bazuar vetëm për pjesët që lidhen me përmbajtjen e paragrafëve të dytë dhe të tretë të nenit 89, germa “b”, të cilat, sipas Gjykatës, duhet të shfuqizohen si në kundërshtim dhe të papajtueshme me Kushtetutën.

Ashtu siç e theksova, ky vendim është i detyrueshëm për t’u zbatuar nga Kuvendi referuar përcaktimeve të nenit 132 të Kushtetutës. Njëkohësisht, në sa është parashtruar edhe në vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe vështirësitë që ka shfuqizimi i këtyre dy paragrafëve të nenit 89, germa “b” të Kodit Penal dhe duke mbajtur në konsideratë që kemi të bëjmë me një ligj që miratohet me shumicë të cilësuar, në cilësinë e relatores të caktuar nga ky këshill për shqyrtimin e vendimit nr. 39, datë 15.12.2022, bazuar në përcaktimin e pikës 5 të këtij neni, propozoj që vendimin nr. 39, datë 15. 12 i Gjykatës Kushtetuese duhet të ketë një diskutim më shterues në Këshillin e Legjislacionit. E para sepse, nëse shfuqizimi i paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 89/b të Kodit Penal krijojnë vakuim ligjor, për të cilat duhet të vendoset nëse duhet të marrë një nismë ligjore Këshilli i legjislacionit, dispozita e shfuqizuar është nismë e deputetit dhe nuk kemi asnjë propozues tjetër

apo ndonjë komision që mund t'i referohemi. Duke u nisur edhe nga praktikat e mëparshme të Këshillit të Legjislacionit, ky është një diskutim që do të duhet ta ndërmarrim ne si Këshill Legjislacioni, lidhur me atë çfarë ka konstatuar dhe diktuar Gjykata Kushtetuese në këtë vendim.

E dyta, referuar pjesës arsyetuese të vendimit nr. 39/2022 të Gjykatës Kushtetuese, paragrafi i dytë i nenit 89/b të parashikohet si dispozitë në seksionin 4, që përmbledh veprat penale kundër shëndetit, të kryera nga pakujdesia. Para se Këshilli i Legjislacionit të vendosë sipas përcaktimeve të nenit 87 të Rregullores së Kuvendit, meqenëse kemi të bëjmë me dispozita ku vetë Gjykata Kushtetuese ka arsyetuar edhe qëllimin e legjislatorit për të miratuar e për të parashikuar pjesën e veprave penale që lidhen me një rrezikshmëri të lartë, sidomos në përdhën e pandemisë, do t'i propozojë Këshillit të Legjislacionit zhvillimin e seancave dëgjimore me përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, të cilat e kanë kontekstin, por dhe ekspertizën sa i përket mënyrës se si do të veprohet me këto dy paragrafë të shfuqizuar të nenit 89/b të Kodit Penal, po ashtu edhe me Prokurorinë e Përgjithshme, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Kjo për të vlerësuar dhe analizuar efektet që krijon në legjislacion shfuqizimi i paragrafit 2 dhe 3 të nenit 89/b të Kodit Penal, por edhe për të vlerësuar nevojën dhe domosdoshmërinë e plotësimit të boshllëkut që krijohet nëpërmjet inicimit të një nisme ligjore për ndryshimin e Kodit Penal, si dhe për të saktësuar atë që Gjykata Kushtetuese e ka vendosur si një moskuptueshmëri të mirë të paragrafëve konkretë të këtij neni të Kodit Penal.

Gjithsesi, kjo mbetet në vlerësimin e Këshillit të Legjislacionit, por unë do të sugjeroja që, meqenëse kemi të bëjmë me një sensitivitet më të lartë dhe me një shumicë të cilësuar të miratimit të Kodit Penal, ne si Këshilli i Legjislacionit të kryejmë një proces më shterues edhe me aktorë të tjerë apo me përfaqësues të institucioneve shtetërore, të cilët kanë gjithë pjesën e ekspertizës, si dhe zbatimin në praktikë të këtyre dy paragrafëve.

Faleminderit, zonja kryesuese!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Gjonaj!

Atëherë, kolegë, për ta përmbledhur edhe një herë, lidhur me vendimin e Gjykatës Kushtetuese kolegia referoi për një nen që i është shtuar Kodit Penal, konkretisht nenit 89/b “Përhapja e sëmundjeve infektive”, si pjesë e nismës së një deputeti të Kuvendit të Shqipërisë, mbi një ligj të cilësuar siç është Kodi Penal.

Me kërkesë të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, dy nga paragrafët e këtij neni që i janë shtuar Kodit Penal, janë shfuqizuar si antikushtetues, dhe bëhet fjalë për paragrafin e dytë dhe të tretë.

Ndërkohë, sugjerimi i relatores është që të bëjmë një diskutim pak më të gjerë në Këshillin e Legjislacionit, nëse duhet të ndërmarrim veprime të tjera, nëse ka boshllëk ligjor në atë që ju mendoni. Të kemi parasysh se ky nen u detyrua, u bë imperative dhe nga vetë konteksti i kohës që kaluam dy vjet më parë. Po ta rikthejmë veten pas në atë periudhë, sigurisht që vërejmë se kemi qenë më të alertuar, ndërkohë që sot jemi më të qetë dhe kemi po ashtu një dije më të gjerë në lidhje me sëmundjet infektive dhe të gjitha pasojat që ato mund të ngërthejnë në vetvete kundrejt jetës dhe shëndetit të njerëzve.

Realisht, mendoj ta çelim si diskutim në lidhje me mënyrën si duhet të operojmë, nëse duhet të draftojmë diçka këtu si Këshill Legjislacioni, nëse duhet të konsumojmë disa seanca dëgjimore apo dhe një seancë dëgjimore, ku të dëgjojmë disa përfaqësues. Besoj se ky diskutim ka rëndësi edhe për vetë faktin se ndryshimi i Kodit Penal nuk është një nismë kaq e lehtë, por në çdo rast do të duhet të jetë shumë e studiuar.

Fjala për ju, zoti Bardhi!

Gazment Bardhi – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, nëse e analizojmë me vëmendje vendimin e Gjykatës Kushtetuese, vërejmë se aty nuk rezulton të jetë krijuar boshllëk ligjor sa i përket parashikimit lidhur me këtë veprë penale. Unë gjykoj se të dyja shtesat që janë bërë, qoftë kur vepra kryhet nga pakujdesia, qoftë kur ka shkaktuar pasoja të rënda, mbulohen nga paragrafi i parë. Në gjykimin tim, në rast të përhapjes së sëmundjeve infektive personi do të duhet të ketë përgjegjësi penale vetëm kur kjo veprë të kryhet me qëllim, pra kur kryhet me dashje. Ky është një parashikim që gjen pasqyrim në paragrafin e parë, i cili është në fuqi dhe nuk është shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese. Ndërkohë, sa u përket pasojave, gjykoj se rast pas rasti ato do të duhet të mbahen në konsideratë nga gjykata në lidhje me përcaktimin e masës së dënimit. Prandaj ka një marzh dënimi nga 2 vjet deri në 5 vjet. Një nga kriteret që vlerësohet është edhe pasoja që ka shkaktuar kryerja e veprës penale.

Në këto kushte unë bie dakord që, edhe për shkak të situatës jo të zakonshme të krijuar nga Covidi, të alertuar nga situata e krijuar, po themi, deputetët bënë disa parashikime shtesë, për t'iu përgjigjur asaj situatë. Kjo edhe për dhënien e një mesazhi në lidhje me zbatimin e rregullave të karantinës, distancimin e me radhë. Në kushtet kur kjo situatë e jashtëzakonshme ka kaluar, në kushtet kur veprat penale të përhapjes së sëmundjeve infektive gjejnë pasqyrim në kod, unë gjykoj se çdo ndërhyrje e mëtejshme në Kodin Penal do të ishte krejtësisht e panevojshme dhe joproportionale. Në gjykimin tim, e përsëris, një person do të duhet të mbajë përgjegjësi për

përhapje të sëmundjeve infektive vetëm në rast se këtë e bën me dashje dhe kur e ka si qëllim bërjen e diçkaje të tillë.

Edhe po të kemi parasysh kushtet e trajtimit të këtyre personave, vuajtjes së dënimit e me radhë, as kushtet nuk janë të tilla që të përballoni një numër të konsiderueshëm njerëzish. Në këto kushte, sa kohë që Gjykata Kushtetuese nuk na ka ngarkuar në dispozitiv, siç ka bërë në vendimet e tjera një javë pas, brenda të cilës ne do të duhet të plotësonim boshllëkun ligjor, nëse në atë rast do të ishim të detyruar të formulonim një dispozitë të re të Kodit Penal, unë nuk mendoj se ka boshllëk ligjor dhe as se do të duhet të nisim, po themi, seanca dëgjimore për të plotësuar këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese. Unë besoj se efektet i ka përcjellë. Shfuqizimi është bërë ngaqë dispozita ka qenë e paqartë, ndonëse sipas këndvështrimit tim formulimi në lidhje me këtë veprë është një formulim që e gjejmë gjerësisht në Kodin tonë Penal. Pra, nuk është se ka qenë vetëm për këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, edhe për të dytin deridiku.

Gjithsesi, për sa kohë që është vendosur nga Gjykata Kushtetuese, që e ka konsideruar jo të qartë formulimin, i ka shfuqizuar këto dispozita, unë mendoj se duhet ta quajmë të përmbushur këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese. Nuk e di kush ka qenë deputeti nismëtar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull! Nuk e kemi këtu, në dijeninë time, për të marrë një opinion të deputetit nismëtar, në lidhje me nevojën e kësaj dispozite. Personalisht, mendoj se për sa kohë nuk ka boshllëk, Kuvendi duhet të përqendrohet te vendimet e tjera të Gjykatës Kushtetuese.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Kolegë, a ka mendime të tjera?

Unë, të them të drejtën, bie dakord me këtë opinion të zotit Bardhi. Nuk mendoj se ka nevojë të ndërtojmë një dispozitë të re, kjo edhe për faktin se do të më dukej i nxituar ndërtimi i një dispozite të re. Mjafton fakti që për përhapjen e sëmundjeve infektive nëpërmjet dashjes direkte ose indirekte, me veprime ose mosveprime ne e penalizojmë, edhe kjo është një përgjigje rreth atij rreziku të madh që mund të shkaktojë. Shkaktoi rreziqe Covid-19, por ne nuk e dimë çfarë mund të sjellë e ardhmja, që mund të sjellë edhe sëmundje të tjera të ngjashme. Sidoqoftë, besoj se ne e kemi vendosur barrierën në legjislacionin penal.

Sipas mendimit tim, paragrafi i dytë, që për më tepër Gjykata Kushtetues e ka shpallur si antikushtetues, nuk qëndron nga pikëpamja e ndërtimit, sepse një element i anës subjektive të veprës nuk mund të përdoret si rrethanë cilësuese në vepër. Ndërkohë, nuk besoj se na krijohet boshllëk, edhe në rastin kur shkaktohen pasoja të rënda. Ne e kemi këtë në Kodin penal si rrethanë rënduese, në nenin vijues të Kodit Penal. Kësisoj, rast pas rasti ligjvënësi zgjedh nëse do ta ngrejë në nivelin e një rrethane të cilësuar, duke e përfshirë në përmbajtjen e dispozitës. Besoj se duke ngelur kjo vepër penale vetëm me një paragraf, është mjaftueshëm për atë detyrim që kemi, sa moral aq edhe ligjor, për të reflektuar një realitet të caktuar në Kodin tonë Penal, kështu që do t'i ftoja kolegët që ne të mjaftoheshim me këtë qëndrim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pikërisht kjo është edhe vështirësia e operimit, pasi ajo u bë në një moment paraprak, gjë që edhe zoti Bardhi e shprehu në fjalën e tij, kur kërkohej vetëdijësimi i njerëzve për masat e karantimit, për masat e distancimit social e të tjera me radhë. Së shpejti, në Komisionin e Ligjeve do të kemi edhe raportin e Prokurorit të Përgjithshëm. Mendoj se vetë procesi i të provuarit është shumë i vështirë. Sidoqoftë, jam dakord që të mbetet ai paragrafi i parë i asaj veprë, në funksion të gjërave që thashë. Atë e ka lënë edhe Gjykata Kushtetuese, por mendoj se është i mjaftueshëm. Nuk e di, nëse Shërbimet...

Mimoza Arbi – Në përgjigje të pyetjes së zonjës Dhurata, nuk ka pasur praktikë. Pra nuk çuam para Gjykatës Kushtetuese as ne që e mbrojtëm në emër të Kuvendit e as kërkuesi, ndonjë vendim të gjykatave të rretheve gjyqësore, që të jetë zbatuar. Por në kontekstin që kjo është nismë e deputetit, dhe 87-a ta jep si detyrim që duhet ta shqyrtojë Këshilli i Legjislacionit, opinioni ka qenë se mund të mos ketë vakuum ligjor, por nuk mund të merret kjo pa pasur edhe një diskutim e një analizë të përgjithshme. Për këtë arsye, edhe relatorja ia ka sugjeruar këtë të Këshillit të Legjislacionit. Edhe sa i përket formulimit, i mbahem qëndrimit të zotit Bardhi, që ne e kemi diskutuar se formulimi është i qartë dhe i zbatueshëm, por ai është gjykim i Gjykatës Kushtetuese.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Arbi!

Atëherë, besoj se e kemi gjithë qëndrimin, që neni 89/b i Kodit Penal do të vijojë të mbetet si i tillë, me vetëm një paragraf, pa qenë e nevojta të reflektohen gjëra të mëtejshme.

Atëherë kalojmë në bllokun e fundit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, ndjesë!

Etilda Gjonaj – Absolutisht që bie dakord edhe unë, nëse ka një dakordësi nga i gjithë Këshilli i Legjislacionit. Gjithë logjika e atij propozimi, pa e përcaktuar unë vetë, pa e përcaktuar unë relativimin tim, ishte më shumë, fakti nëse përbën boshllëk apo jo. Duke pasur një shfuqizim të pjesshëm nga Gjykata Kushtetuese, mbase do të ishte mirë – dhe kjo ka qenë logjika – mbase do të ishte mirë të pyeteshin vetë institucionet ligjzbatuese, por edhe institucionet që janë marrë në atë periudhë me propozimin e një sërë dispozitash që plotësonin kuadrin ligjor në kohë pandemie. Sepse, Kodi ynë Penal ka qenë i vetmi që nuk ka pasur një dispozitë në lidhje me përhapjen e sëmundjeve infektive. Kjo ka qenë arsyeja pse është shtuar me propozim të deputetit në atë kohë. Kjo për të kuptuar më shumë nëse kjo normë, me shfuqizimin e këtyre dy paragrafëve nga Gjykata Kushtetuese, krijon një pengesë në zbatueshmërinë e saj normale. Kjo ka qenë e gjithë logjika.

Por nëse i gjithë Këshilli i Legjislacionit mendon se nuk ka më nevojë për ta shteruar, qoftë edhe me marrjen e disa opinionëve nga institucionet, atëherë jam dakord me të gjitha propozimet që vijnë nga anëtarët e këshillit.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Gjonaj!

Atëherë kalojmë në shqyrtimin e bllokut tjetër të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Në fakt, ne i kemi ndarë kështu për lehtësi operimi. Bëhet fjalë për vendimet numër 1 dhe numër 2, datë 18 janar 2023 të Gjykatës Kushtetuese, që lidhen me konfliktin e kompetencës midis Kuvendit të Shqipërisë dhe një grupi deputetësh.

Zonja Bushka është relatores për këto dy vendime, që ne kemi menduar t'i merrnim në shqyrtim e në analizë, në mënyrë integrale, sepse lidhen me të njëjtin objekt. Zonja Bushka është prezente, dhe do të na relatojë.

Klotilda Bushka –Faleminderit!

Atëherë unë po bëj një relativim për të dy vendimet. Konkretisht, bëhet fjalë për vendimet nr. 1 dhe nr. 2, datë 18 janar 2023. Vendimi nr. 1 ka vendosur pranimin e kërkesës, zgjidhjen e konfliktit të mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe subjektit kushtetues në konflikt, jo më pak se një e dhjeta e deputetëve, zgjidhjen e konfliktit të marrëveshjes së kompetencës ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe subjektit kushtetues në konflikt jo më pak se një e dhjeta e deputetëve, shfuqizimin e vendimit 83, 17.11. 2022 “Për mosmiratimin e raportit të pakicës parlamentare në Këshillin për Rregulloren, mandatet dhe Imunitetin”, me objekt

“Konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka”, dhe nr. 84, 17. 11. 2021 “Për miratimin e raportit të shumicës parlamentare”.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare. Ndërsa me vendimin 2/ 2023, Gjykata Kushtetuese ka vendosur pushimin e gjyqimit të çështjes. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Sipas nenit 87 të Rregullores, mënyra e veprimit dhe organi kompetent për shqyrtimin e këtyre vendimeve jepet qartësisht në këtë dispozitë. Këshilli për Legjislacionin është kompetent për shqyrtimin e zbatimit të këtyre dy vendimeve.

Unë kam marrë në analizë të dy vendimet, edhe memon e Shërbimeve Juridike të Kuvendit. Në fakt, kam shfletuar edhe jurisprudencën e mëparshme të Gjykatës Kushtetuese, jurisprudencën dhe opinionet e Komisionit të Venecias. Kam bërë edhe një analizë krahasuese të legjislacioneve përkatëse në rajon e në Europë, në lidhje me këto çështje. Fillimisht, para se të nis relativimin, dy fjalë për të drejtën e organit përkatës për të vlerësuar në lidhje me sjelljen dhe mandatin e anëtarëve të kuvendeve. E drejta e organit ligjvënës, pra e parlamenteve, për të vlerësuar në lidhje me sjelljen dhe mandatin e anëtarëve të vet, ka qenë dhe është një e drejtë e një privilegj i mëparshëm i këtij institucioni jo vetëm në Shqipëri, por edhe në shumicën e vendeve që unë kam marrë në shqyrtim.

Kolegë, unë po përpiqem të bëj një përmbledhje për ekonomi kohe, pasi kam një material shumë voluminoz, që të jap vetëm thelbin e asaj që dua të relatoj. Siç thashë, kjo duket qartë në shumë vende, ndonëse kushtetutëbërësit kanë filluar të përfshijnë në këto procese edhe instanca të ndryshme gjyqësore, por gjithsesi, parlamentet respektive vazhdojnë të ruajnë kompetenca të rëndësishme e thelbësore në vendimmarrje të tilla. E drejta e kuvendeve, e parlamenteve, e legjislativit për të vendosur mbi anëtarët e parlamenteve të ndryshme, është një prerogativë e natyrshme e vetë parlamentit, që buron qysh nga origjina e këtij institucioni.

Megjithëse në këto procedura janë përfshirë edhe organe gjyqësore, kryesisht gjykatat kushtetuese, ose gjykatat e rangjeve të larta, që ushtrojnë e që kanë edhe juridiksion kushtetues, përsëri kompetenca e parlamentit në atë shtet nuk është formale, mbetet substanciale, duke qenë se kjo e fundit është vendimmarrëse në lidhje me faktin nëse do ta çojë një deputet në një gjykim për fatin e mandatit të tij apo të saj.

Edhe në hartimin e Kushtetutës së 1998-ës, është ruajtur kjo qasje në Shqipëri, kjo duket edhe nga diskutimet e anëtarëve në atë kohë se cili ka qenë vullneti i kushtetutëbërësit në lidhje me prerogativën vendimmarrëse thelbësore. Po t'i referohemi gjuhës së përdorur në hartimin e

dispozitave dhe tekstit të saj, ku përcaktohet se në raste të papajtueshmërisë së mandatit të deputetit (për ato raste të konfliktit të interesit, të cilat çojnë në papajtueshmëri, sepse jo çdo rast konflikti interesi çon në papajtueshmëri) Kushtetuta parashikon termin “vendos”, term ky që, sipas kuptimit gjuhësor, nuk ka një natyrë formale, por një natyrë substanciale. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë ka marrë në trajtim nenin 70, që flet për rastet e papajtueshmërisë së deputetit në 8 raste në 8 vendime. Me qëllim që të jemi të drejtë në zbatimin e vendimeve aktuale, do të na duhet të marrim në konsideratë në mënyrë konsistente të gjithë praktikën e mëparshme të kësaj gjykate.

Edhe po t’i referohemi Komisionit të Venecies, në opinionin e 23 nëntorit të vitit 2018, situatat e shqyrtimit të papajtueshmërive të mandateve të deputetëve dhe vendimmarrjes në lidhje me to, theksin e venë te prerogativa e kuvendeve.

Nëse do t’i referohemi vendimit nr.1/2023 të Gjykatës Kushtetuese, parë në këndvështrimin e asaj që vendos dhe të jurisprudencës së mëparshme të Gjykatës Kushtetuese, nisur edhe nga këto që kam studiuar, siç edhe i përmenda më sipër, Gjykata Kushtetuese në fund të arsytimit të saj në vendimin nr.1, datë 23.01.2023, ka konkluduar: “Në këndvështrim të sa më lart, si dhe rrethanave të rastit konkret, gjykata vëren se Kuvendi nuk mund të vendosë në themel nëse deputetja në fjalë përmes bashkëshortit të saj ka kryer veprimtari fitimprurëse, që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe nëse ka fituar pasuri të këtyre të fundit, si dhe nëse veprimet apo mosveprimet e deputetes përmes bashkëshortit të saj përbëjnë shkelje të pikave 2 ose 3 të nenit 70 të Kushtetutës”.

Nëse do t’i referohem kësaj që lexova deri tani, jo vetëm këtij arsytimi, por të gjithë vendimit në tërësi, në pjesën më të madhe Gjykata Kushtetuese citon jurisprudencën e saj të mëparshme, e cila është reflektuar edhe në këtë vendim. Të rejat e këtij vendimi, pra të vendimit nr. 1, dhe trajtimi i çështjes konkrete fillojnë në paragrafin 49 të vendimit, sipas të cilit gjykata evidenton se termi “mocion” në Kushtetutë gjendet përveçse në nenin 70, pika 4, dhe nenin 104 në lidhje me mocionin e besimit ndaj Këshillit të Ministrave dhe nenit 115 të saj në lidhje me mocionin e mosbesimit ndaj Kryeministrit, në këtë kuptim mocioni është një instrument parlamentar, që ka për qëllim të nxisë një diskutim në Kuvend për një çështje të caktuar dhe për të cilën duhet të ketë një vendimmarrje nga ky i fundit. Pavarësisht se mocioni është një akt parlamentar i drejtimit politik, ai ka një pasojë juridike ngushtësisht të lidhur me çështjen në diskutim. Për herë të parë Gjykata Kushtetuese i referohet duke i dhënë kuptim fjalës “mocion”, e

cila përmendet në nenet 70, 104 dhe 105 të Kushtetutës. Duke e përkufizuar si një mjet që ka për qëllim të nxisë diskutimin për një çështje të caktuar, arrihet në konkluzionin që për sa i takon mocionit për shkarkimin e një anëtari të Kuvendit në rastet e papajtueshmërisë, që parashikon neni 70/3, do të duhet të diskutohet, pra do të duhet të zhvillohet një debat. Ndërkohë që, nga vetë praktika e mëparshme e vetë Gjykatës Kushtetuese, është pikërisht vendimi nr. 7, datë 24.02.2016, rezulton, nga teksti i paragrafit 30 të këtij vendimi, se vetë kjo gjykatë ka mbajtur qëndrimin: “Nuk mund të vihet në diskutim një mocion i paraqitur dhe nuk mund t’i nënshtrohet debatit parlamentar”. Në këtë rast, në vendimin aktual, këtë që po diskutojmë vendimin nr. 1/2023, duket se është ndryshuar qëndrimi i gjykatës në këtë pikë dhe, referuar po kësaj që thashë, po t’i referohemi edhe një vendimi tjetër të Gjykatës Kushtetuese, që është vendimi nr. 21, datë 29.04.2010, vetë Gjykata Kushtetuese shprehet: “Në aspektin kushtetues është e pamundur dhe e palejueshme që doktrina zyrtare kushtetuese të riinterpretohet në mënyrë të tillë që ndryshon sistemin e vlerave të sanksionuara në Kushtetutë. Çdo ndryshim i precedentëve të Gjykatës Kushtetuese apo korrigjimi i doktrinës kushtetuese zyrtare nuk mund të bëhet mbi bazën e faktorëve të rastit, siç mund të jetë dhe ndryshimi i përbërjes së saj”.

Nga e gjithë kjo që thashë, rezulton se jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese është detyruese për t’u ndjekur nga institucionet kushtetuese ligjore, madje është detyruese edhe për vetë Gjykatën Kushtetuese. Kemi dy qëndrime të Gjykatës Kushtetuese në dy vendime, çka është e lejuar, sepse patjetër edhe qëndrimi i jurisprudencës kushtetuese ndryshon në varësi të dinamikave dhe sipas kriterëve që përcakton vetë jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, por duhet të jetë e bazuar, e arsyetuar, ndërkohë që në vendimi nr. 1, datë 23.01.2023, nuk ka një arsyetim në lidhje me këtë ndryshim të jurisprudencës. Megjithëse në paragrafët 50 dhe 51 gjykata e ka përsëritur jurisprudencën e mëparshme, mundohet ta kufizojë mundësinë për debat vetëm në vlerësimin e kriterëve formale të mocionit të paraqitur. Paragrafi 52 ka këtë qëndrim: “Nën dritën e standardeve të sipërpërmendura, gjykata rithekson se Kuvendi shqyrton vetëm nëse mocioni i paraqitur ka të bëjë me papajtueshmërinë e mandatit të deputetit. Shqyrtimi juridiko-formal do të thotë që organi juridiksional, në këtë rast Kuvendi, nuk zhvillon hetim për përcaktimin e fakteve. Pra, nuk shqyrton dhe debaton provat, me qëllim përcaktimin e fakteve dhe rrethanave. Në këtë lloj procedura Kuvendi vlerëson *prima facie*, nëse pretendimi i paraqitur në mocion është haptazi i pabazuar ose jo. Fakti që pretendimi i parashtruar në mocion nga një e dhjeta e deputetëve ose Kryetari i Kuvendit, kundërshtohet nga një pjesë tjetër e deputetëve të Kuvendit, nuk duhet të

përbëjë shkak për mosmiratimin e mocionit, sepse qëllimi i shqyrtimit juridiko-formal nuk është të vërtetojë papajtueshmërinë e mandatit të deputetit”. Pra, thotë Gjykata Kushtetuese në vendimin aktual. Tani, nëse e lexojmë këtë paragraf, i gjithë paragrafi flet për vlerësimin juridiko-formal të mocionit të paraqitur. Në brendinë e tij parashikohet edhe mundësia që Kuvendi të vlerësojë *prima facie* nëse ky pretendim i paraqitur është haptazi i pabazuar ose jo. Ky vlerësim, në gjykimin tim, nuk është më në natyrë formale. Kolegë, në këtë arsytim jam përpjekur të mos shikoj vetëm dispozitivin, por të gjithë arsyetimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, sepse është po detyrim nga praktika e vetë Gjykatës Kushtetuese edhe nga jurisprudenca që në ekzekutim duhet të jenë të gjithë qëndrimet e Gjykatës Kushtetuese.

Për t’ju rikthyer çështjes së mocionit, nëse mocioni do të kishte mangësi formale, Kuvendi do të mund të kërkonte plotësimin e këtyre mangësive, si: paraqitja e provave, paraqitja në formën e kërkuar nga ligji e të tjera, të cilat, nëse nuk do të plotësoheshin, do të sillnin si pasojë mosshqyrtimin e mocionit, por jo rrëzimin si të pabazuar *prima facie*.

Në një vlerësim për bazueshmërinë *prima facie* të mocionit, kur këtij i mungojnë elementet formale, do të ishte edhe objektivisht e pamundur të merrej në shqyrtim. Vlerësimi nëse një kërkesë mocioni është *prima facie*, haptazi e pabazuar në legjislacionin shqiptar, po t’i referohemi për të gjetur një analogji se ku e gjejmë për herë të parë, ose ku parashikohet, është vetëm te ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, parashikohet në nenin 31/ “a”, ku jepen të gjitha kriteret, dhe nuk bëhet fjalë vetëm për kriteret formale, por hyhet dhe në atë që nëse kërkesa i përmbush kriteret për t’u marrë në shqyrtim apo jo. Këtë ka mbajtur në konsideratë edhe legjislatori kur ka bërë ndryshimet e ligjit “Për Gjykatën Kushtetuese”, por edhe ndryshimet e Rregullores së Kuvendit për sa u takon trajtimin të këtyre kërkesave. Duke u bazuar në natyrën e kontrollit *prima facie* të një mocioni dhe me analogjinë, për aq sa mund të bëhet, me atë që parashikohet në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, Kuvendi ka të drejtën të bëjë edhe një vlerësim për themelin, për kërkesën për mocion, vetëm në kuadrin *prima facie*, pra, pa i hyrë nëse jemi apo jo para rasteve, por thjesht për të ndarë, nëse, sipas nenit 70 të Kushtetutës, jemi para rasteve të konfliktit të interesit, nga ato që parashikon paragrafi 2 i nenit 70 apo paragrafi 3 i nenit 70. Pse e them këtë? Paragrafi 2 i nenit 70 flet për ato raste që trajtohen nga vetë Kuvendi apo nga organet e tjera legjislative. Vetë Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrim që për këto raste ajo nuk është kompetente, ndërsa për rastet e nenit 70, pika 3, është kompetente, por në këtë rast i takon Kuvendit, i cili vihet në lëvizje me kërkesën e një të dhjetës së deputetëve

ose të Kryetarit të Kuvendit të shqyrtojë këtë ndarje. Në një shqyrtim *prima facie*, pa diskutim që kjo ndarje do të bëhet duke u bazuar në disa kritere, të cilat, në fakt, i parashikon Rregullorja.

Në vendimin aktual është bërë një arsyetim se çfarë nënkuptohet me “*prima facie*”, por rezulton po nga ai vendim që konsiderohet edhe substancial, pra nuk del vetëm në aspektin formal. Megjithatë, nëse do ta pranojmë ta zbatojmë ashtu siç është thënë, ne nuk kemi në Rregulloren e Kuvendit një dispozitë përkatëse për mënyrën se si duhet të veprojmë. Rregullorja e Kuvendit është ndryshuar pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2016, kur ka qenë rasti i papajtueshmërisë së mandatit të deputetit Koço Kokëdhima dhe atje është bërë një interpretim i nenit 70 të Kushtetutës, pas atij interpretimi është ndërruar edhe Kushtetuta; janë ndryshimet që janë bërë në kuadër të gjithë grupit të propozimeve të reformës në drejtësi. Janë prekur nenet 131, 134, neni 70 ka ndryshuar, por ndërkohë është parashikuar qartësisht e drejta e një të pestës së deputetëve të Kuvendit për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, në mënyrë që të kërkojnë papajtueshmërinë e mandatit të deputetit. Edhe Rregullorja e Kuvendit për t’u përshtatur me këtë praktikë është ndryshuar. Po ta shikojmë, në atë kohë vullneti i ligjvënësit në të gjitha nismat ligjore dhe ndryshimet kushtetuese, por edhe ato ligjore, se është ndryshuar edhe ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” ka qenë se është Kuvendi ai që e dërgon një kërkesë për papajtueshmëri të mandatit të deputetit në Gjykatën Kushtetuese dhe vendos në seancë plenare për këtë. Një subjekt tjetër është një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Të dyja këto janë përpjekur të trajtohen në Rregulloren e Kuvendit, të cilat, në fakt, në situatën e sotme, me vendimin nr. 1/2023 për sa i përket mocionit të një të dhjetës së deputetëve dhe natyrës së shqyrtimit *prima facie* të mocionit, e kemi në Rregulloren e Kuvendit të patrajtuar me procedurë përkatëse.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të mbaroj unë, pastaj mund të flasësh. Lexova, derisa arrita këtu.

Në paragrafin 54 të vendimit të saj Gjykata Kushtetuese arsyeton: “Në këndvështrim të sa më sipër, si dhe rrethanave të rastit konkret, gjykata vëren se Kuvendi nuk mund të vlerësojë në themel, nëse deputetja në fjalë përmes bashkëshortit ka kryer veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe nëse ka fituar pasurit të këtyre, si dhe nëse veprimet, mosveprimet përmes bashkëshortit të saj përbëjnë shkelje të pikave 2 ose 3 të nenit 70 të Kushtetutës.” Kuvendi, sipas konkluzioneve të këtij pasazhi, nuk ka mundësi të vlerësojë vetë nëse mocioni i paraqitur përfshihet brenda fushës së veprimit të pikës 2 të nenit 70 apo të pikës 3

të po këtij neni. Ky vlerësim i takon Gjykatës Kushtetuese. Kjo qasje e Gjykatës Kushtetuese duket që nuk është në përputhje me praktikën e saj të mëparshme, ku vetë ajo në vendimin nr.72, datë 07.12.2016, është shprehur: “Gjykata e vlerëson këtë pretendim si të pambështetur. Pika 2 e nenit 70 të Kushtetutës përbën një rregullim specifik dhe, bazuar në rregullin interpretues sipas të cilit norma specifike ka përparësi mbi normën e përgjithshme, kjo dispozitë ka përparësi mbi nenin 131, i cili përmban një rregullim të përgjithshëm, ku listohen kompetencat e Gjykatës Kushtetuese”. Në konkluzion, Gjykata vlerëson: “Konstatimi i papajtueshmërisë së mandatit të deputetit është në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese vetëm në rastin e parashikuar nga neni 70/3”. Pra, vetë Gjykata Kushtetuese thotë që vetëm për 70/3 do të jetë ajo kompetente dhe vazhdon fjalia po në arsyetimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2016, dhe thotë: “Kurse për të gjitha rastet e tjera legjislatori ka parashikuar vetë Kuvendin si institucion, i cili vendos për heqjen ose jo të mandatit të deputetit”.

Në vendimmarrjen e saj të mëparshme Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar: “Vlerësimi i cenimit ose jo nga ana e deputetit të pikës 2 të nenit 70 të Kushtetutës është në kompetencën e Kuvendit të Shqipërisë dhe jo të Gjykatës Kushtetuese”. Në këtë rast kjo qasje e re e Gjykatës Kushtetuese, në gjykimin tim, nuk përmbush edhe standardet për ndryshimin e praktikës gjyqësore, sipas përcaktimit të vendimit nr. 21, datë 29.04.2010.

Ajo që krijon problematikë në këtë situatë, është se, po t’i referohemi vendimit tjetër të janarit 2023 po për rastin e mandatit të deputetes, zonjës Olta Xhaçka, Gjykata Kushtetuese për të njëjtat veprime ka mbajtur qëndrimin se për sa i përket kërimit për konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes për shkelje të ndalimeve, sipas pikës 2 të nenit 70 të Kushtetutës, gjykata mban në vëmendje jurisprudencën e saj. E theksoj, flet për pikën 2 të nenit 70 dhe bën të gjithë analizën e jurisprudencës së mëparshme, pa bërë një sqarim pse tani kemi kaluar nga një qëndrim vetëm për paragrafin 3 të nenit 70, në një qëndrim për paragrafin 2 të nenit 70.

Nuk e di nëse e vetmja mundësi konkludimi në mënyrë **pajtuese** midis dy vendimmarrjeve të Gjykatës Kushtetuese, mund të ishte që Kuvendi në çdo rast, kur na paraqitet një mocion i tillë, duhet t’ia çojë atë Gjykatës Kushtetuese, pa marrë asnjë vendim, që më pas do të vlerësonte nëse ishim te 70/2 apo te 70/3. Pra, do të ishim te rastet e papajtueshmërive që parashikon paragrafi 2 i nenit 70 apo i papajtueshmërive të parashikuara në paragrafin 3 të nenit 70 dhe ta zgjidhte vetë gjykata nëse do ta mbante ose jo çështjen. Por gjithë baza ligjore, me të cilën vepron Kuvendi dhe

ajo procedurale, kanë parashikime të ndryshme. Edhe sikur të ishte kjo qasja, pasi nuk del qartë nga tërësia e arsytimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, kjo do të krijonte problematika në disa aspekte.

Së pari, ne do ta detyronim Kuvendin të mbliidhej në çdo rast në mënyrë detyruese në një formë të caktuar dhe neni 70, pika 4, do të ishte i pazabatueshëm. Neni 70, pika 4 e Kushtetutës parashikon që Kuvendi vendos për kërkesën e një të dhjetës apo të Kryetarit të Kuvendit në lidhje me rastin e papajtueshmërisë. Këtu dua të bëj një diferencë: nuk është sipas parashikimit tjetër kushtetues për sa u takon komisioneve hetimore, ku Kushtetuta thotë: “Kuvendi është i detyruar ta dërgojë çështjen”, pra këtu kemi një dallim. Këtë e them për të qartësuar për ne, kolegë se, kur Kushtetuta parashikon që Kuvendi vendos, edhe sikur të biem dakord që e paskemi një kompetencë formale dhe jo substanciale, problematika na krijohet me një normë tjetër kushtetuese, që është pika 1 e nenit 70. Mandati i deputetit nuk është detyrues dhe ka vetë një vendimmarrje të mëparshme të Gjykatës Kushtetuese, vendimi nr. 44, datë 07.10.2011, i cili thotë: “Mandati parlamentar është i përgjithshëm, pra parlamentarët përfaqësojnë kombin si të tërë dhe jo një grup votuesish; ata janë përfaqësues të të gjithëve...” e të tjera, që të mos e përmend të gjithën, por në thelb deputeti i bindet bindjes së tij, ndërgjegjes së tij dhe përfaqësimit që ai i bën popullit, pa iu nënshtruar urdhrave apo kërkesave të ndryshme.

E përsëris edhe një herë diferencën midis kompetencës që ka Kuvendi për të vendosur në rastin e rasteve të papajtueshmërisë së mandatit (pika 4 e nenit 70), ku thuhet se “Kuvendi vendos”, me ndryshimin që parashikon Kushtetuta në komisionet hetimore, ku thuhet: “Kuvendi është i detyruar të vendosë”.

Në rastin e vendimeve që merr Kuvendi i Republikës së Shqipërisë për ngritjen e komisioneve hetimore, kjo është një prerogativë (një detyrim) kushtetuese, e cila nuk bie ndesh me parashikimin kushtetues, se mandati i deputetit nuk është detyrues. Në rastin e shqyrtimeve të papajtueshmërive të mandatit të deputetit, pika 4 e nenit 70, është kompetencë substanciale e Kuvendit për të vendosur, çka do të thotë që deputetët nuk duhet të jenë detyruar në ushtrimin e mandatit të tyre, sa i takon kësaj pike. Detyrimi për ta vendosur në mënyrë formale, pra për ta bërë thjesht noterët dhe për ta dërguar çështjen, do të duhet të shihet në pajtueshmëri ose jo me paragrafin 1 të nenit 70, ku mandati i deputetit nuk është i detyrueshëm.

Po heq disa faqe për ta përmbledhur dhe të mos ju marr kohë, se ideja del.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Bardhi, ju lutem, unë po përpiqem t'i përmbledh dhe të mos lexoj faqe të tëra!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kuvendi i Shqipërisë, për të gjitha çështjet që përmenda deri në këtë moment, si për mënyrën si e trajton një mocion të 1/10-ës së kolegëve deputetë, si për mënyrën si e trajton një mocion të Kryetares së Kuvendit, si për natyrën e vendimmarrjes së Kuvendit (nëse është formale apo substanciale), ashtu dhe sa i takon procedurës se si vepohet në këto raste, ka një bazë ligjore. Rregullorja e Kuvendit, nëse do t'i referohemi situatës së re të krijuar me vendimin nr. 1/2023, nuk ka parashikime të qarta për mënyrën e zhvillimit të këtij procesi, duke respektuar edhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor në të tilla raste. Prandaj për zbatimin e vendimit, nëse do të gjykonim, do të duhej patjetër të ndërhyjmë në Rregulloren e Kuvendit.

Nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese që nga viti 2011 deri në vitin 2016 dalin disa konkluzione: Kushtetuta parashikon dy raste të papajtueshmërisë së veprimtarisë së deputetit: ajo e parashikuar në pikën 2 të nenit 70 dhe ajo e parashikuar në pikën 3 të nenit 70. Kuvendi është organ që shqyrton kërkesat që paraqiten për papajtueshmërinë e mandatit të deputetit. Në rastin e pikës 2 të nenit 70 kjo papajtueshmëri vlerësohet nga vetë Kuvendi si nga ana formale, ashtu dhe për bazueshmërinë në themel.

Në rastin e pikës 3 të nenit 70, Kuvendi vlerëson vetëm anën formale të kërkesës dhe është i detyruar t'ia dërgojë çështjen Gjykatës Kushtetuese. Në këto raste kërkesa nuk i nënshtrohet debatit parlamentar. Gjykata Kushtetuese vlerëson vetëm rastet që parashikohen në pikën 3 të nenit 70.

Ndërkohë, sa u takon subjekteve që legjitimohen, Kuvendi, në vitin 2016 miratoi ligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, ku ndër të tjera, në nenin 57, duke ndryshuar tërësisht nenin 66, tashmë përcaktonhet se për shqyrtimin e zgjedhjes së deputetëve Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesën e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, të jo më pak se 1/5-tës së deputetëve të Kuvendit, ose të partive politike. Për shqyrtimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksioneve të deputetëve Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të Kuvendit ose 1/5-tës së deputetëve.

Gjykata Kushtetuese verifikon, sipas Kushtetutës, zgjedhjen e deputetëve me kërkesë të partisë politike ose kandidatit të pavarur për deputet.

Në këtë rast, me këtë ndryshim, Kuvendi riafirmoi vullnetin e vet që 1/5-ta e deputetëve është subjekt që i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për çështje të tilla dhe që vënë në lëvizje gjykimin

kushtetues. Më tej, me vendimin nr. 85/2019 Kuvendi ka shtuar nenin 190/1 në Rregulloren e Kuvendit, e cila parashikon të gjithë procedurën që ndjek Kuvendi në këto raste. Qëllimi i parashikimit ishte që të përputhim Rregulloren e Kuvendit me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, duke mbajtur edhe kushtetutëbërësi, në atë kohë, vullnetin e vet se cilat ishin subjektet kushtetuese që i drejtoheshin Gjykatës Kushtetuese.

Me vendimin nr. 2 të Gjykatës Kushtetuese, që është objekt trajtimi i Këshillit për Legjislacionin, sa i takon ekzekutimit të tij, me të cilin është vendosur pushimi i gjykimit të çështjes, duket se është krijuar një situatë juridike, e cila, sipas gjykimit tim, dhe jo vetëm, 1/5-tës së deputetëve i është hequr e drejta që të legjitimohet si subjekt kërkues për këto lloj shqyrtimesh. Po t'i referohemi vendimit nr. 7 të vitit 2016, këta (1/5-ta) janë trajtuar si një nga subjektet që parashikoheshin në nenin 134 të Kushtetutës dhe menjëherë pas këtij vendimi Kushtetuta ndryshoi dhe u riafirmua edhe një herë e drejta e 1/5-ës së deputetëve për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Fill pas ndryshimit kushtetues u miratua edhe ligji "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", ku e drejta e 1/5-tës së deputetëve për t'iu drejtuar direkt Gjykatës Kushtetuese u sanksionua.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është risanksionuar edhe pas një vendimi tjetër, është riafirmuar.

Pavarësisht se pas këtij vendimi Kuvendi ndërhyri në mënyrë legjislative, duke sjellë me ligjin nr. 99/2016 nenin 57, ndryshimin e nenit 66 të ligjit nr. 8577 të vitit 2000, si dhe duke përcaktuar si subjekt kërkues në këtë lloj gjykimi edhe grupimin prej jo më pak se 1/5-tës së deputetëve, pavarësisht kësaj norme të re ligjore, Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 1, datë 23 janar 2023, mbajti këtë qëndrim që, gjatë interpretimit të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese ka theksuar parimin se norma e posaçme ka përparësi mbi normën e përgjithshme. Sipas saj, në rastet e procedurave për njehsimin e kontrolli kushtetues të papajtueshmërisë me detyrën dhe vlerësimin të mandatit të deputetit, dispozitat e pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës përbëjnë normën e posaçme. Për rrjedhojë, ajo prevalor mbi parashikimin e përgjithshëm të nenit 131 dhe nenit 134, ndërsa me vendimin nr. 2 të janarit të vitit 2023 Gjykata Kushtetuese u vu në lëvizje nga një grup deputetësh, në cilësinë e subjektit, prej jo më pak se 1/5-tës së deputetëve. Qëndrimi i Gjykatës Kushtetuese, në këtë rast, ishte që, për sa i përket nënkërkimit për konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetit për shkelje të ndalimeve, sipas pikës 3 të

nenit 70, ka marrë përgjigje në vendimin e saj nr. 1 të vitit 2023, pra vendimin e së njëjtës ditë, vendimin me të cilin kërkues ishte 1/10-ta e deputetëve.

Siç u parashtruar më lart në këtë vendim, po citoj Gjykatën Kushtetuese: “Në koherencë me jurisprudencën e saj Gjykata ka ritheksuar se në zbatim të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës, 1/10-ta e deputetëve ka të drejtë të paraqesë mocion për konstatimin e papajtueshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetit, ndërsa vendimmarrja e Kuvendit është e domosdoshme, me qëllim vënien në lëvizje të kësaj Gjykate për t’u shprehur për themelin e çështjes. Për sa kohë që ka një vendim të këtij organi, gjykata nuk mund të shqyrtojë kërkesa të tilla. Ndërkohë, në pikën 4 të nenit 70 përcaktohet se për çdo shkelje të paragrafit 3 të këtij neni, me mocion të kryetarit të Kuvendit ose të një së dhjetës së anëtarëve të tij, Kuvendi vendos për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila konstaton papajtueshmërinë.

Unë citova çfarë ka arsyetuar Gjykata Kushtetuese, dhe në këto kushte, duke iu referuar parashikimeve në ligjin 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, neni 66, siç është ndryshuar nga neni 57 i ligjit nr. 99/2016, pika 2, togfjalëshi “...ose 1/5-tës së deputetëve...” duhet të shfuqizohet, nëse do t’i referohemi vendimit nr. 2 të vitit 2023 të Gjykatës Kushtetuese, në mënyrë që të shmanget në të ardhmen paraqitja e kërkesave të ndryshme dhe konfuze, që mund të konkurrojnë kompetencën e Kuvendit për ta vënë në lëvizje ose jo Gjykatën Kushtetuese. Mbi këtë bazë duhet të bëhen edhe rregullimet në pikën 2 të nenit 66 “a”, shtuar me nenin 58 të ligjit nr. 99/2016 sa i përket afatit për vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese. Kjo rezulton nga arsyetimi dhe dispozitat e të dyja vendimeve.

Në gjykimin tim, situata që krijohet me të dyja vendimet, ka nevojë për një shqyrtim tërësor, të thellë, nëse jemi para rastit të zbatimit të drejtpërdrejtë apo të ndryshimit të legjislacionit. Unë gjykoj se kemi nevojë për ndryshimin e legjislacionit, por për këtë nuk mund të vendosim ne, se kjo ka të bëjë me vullnetin e kushtetutëbërësit.

Dua të theksoj se, në lidhje me problematikat që konstatohen (veçanërisht ato që lidhen me vendimin nr. 1 të vitit 2023), ne kemi nevojë të thellohem në konsistencën e praktikave të mëparshme të Gjykatës Kushtetuese, në ngritjen e pikëpyetjeve që krijohen nga qëndrime të ndryshme në vendime të ndryshme. Në fakt, e ka pranuar edhe pakica e vetë Gjykatës Kushtetuese në paragrafin 19 dhe pakica e dytë në paragrafin 7, pra në vendimin nr. 1 dhe nr. 2. Do të duhet të sigurojmë sqarimin e “mocionit” si fjalë, si term, që përmendet në nenin 70, pika 4, të Kushtetutës.

Nisur edhe nga përkufizimi i vetë Gjykatës Kushtetuese në paragrafin 49 të vendimit të saj, mendoj se duhet të sqarohet edhe kontrolli i Kuvendit për rastet e pikës 2, të nenit 70, të Kushtetutës.

Po t'u referohemi paragrafëve 52 dhe 54 të vendimit nr. 1 të vitit 2023 dhe paragrafëve 26, 31 dhe 33 të vendimit nr. 2 të vitit 2023 (se tani kemi dy praktika), do të jemi kompetentë vetëm për rastet e pikës 2 të nenit 70, apo nuk do t'i trajtomë as këto raste? Sepse Gjykata Kushtetuese ka sqaruar se, nëse do të duhet të bëhet ndarja, kur jemi para rastit të pikës 2 apo 3, është vetë Gjykata që e bën vlerësimin.

Siç e parashtrova, mendoj se sqarimi i kontrollit *prima facie* të Kuvendit është i nevojshëm, deri aty ku shtrihet, sepse, nëse biem dakord, do të na duhet të bëjmë ndryshime edhe në Rregulloren e Kuvendit dhe do të duhet të jemi të qartë se deri ku shkon ky lloj kontrolli dhe se ku do të referohemi për këtë, duhet të sqarojmë gjithashtu, nëse është e nevojshme të bëjmë amendime në nenit 66 të ligjit nr. 8577, të datës 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", përderisa në të dyja vendimet aktuale të Gjykatës Kushtetuese duket se parashikimi i subjektit "jo më pak se 1/5-ta e deputetëve për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese" del sikur nuk legjitimohet, apo sikur 1/5-tës së deputetëve i është mbyllur dera për t'iu drejtuar me një kërkesë Gjykatës Kushtetuese.

A keni nevojë për ndryshime të tjera kushtetuese, si nenet 70, 131 dhe 134 të Kushtetutës?

Të nderuar kolegë, të gjitha këto janë çështje që më kanë rezultuar nga studimi i vendimeve, i praktikës së Gjykatës, i rasteve të marra në shqyrtim nga vende të tjera. Shërbimi Juridik i Kuvendit ka vënë në dispozicion një studim krahasues, dhe e falënderoj për punën e bërë shumë mirë, i cili mendoj se ka nevojë për thellim!

Unë nuk jam në gjendje të bëj një propozim, por ajo që mund të propozoj për Këshillin për Legjislacionin, duke qenë se bëhet fjalë për çështje të rëndësishme që mund të implikojnë edhe ndryshime kushtetuese dhe ligjore (kuptohet, nëse do të ekzistojë një vullnet i tillë, i cili duhet të jetë i bazuar në mendime juridike e shkencore që të formësohet), është që për të gjitha pikëpyetjet kolegët të kërkojnë ekspertizë nga ekspertë kushtetutëbërës dhe t'u japin përgjigje pyetjeve para se të marrim një vendim.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Bushka!

Atëherë, do të operojmë në të njëjtën mënyrë.

Po, zoti Bardhi.

Gazment Bardhi – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, secili prej nesh, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, në nisje të ushtrimit të mandatit është betuar për respektimin e Kushtetutës dhe unë mendova se kolegja ime Bushka do ta niste fjalën duke kërkuar ndjesë që, me raportin e propozuar për miratim në seancë, nxiti shumicën parlamentare të shkelte në mënyrë flagrante Kushtetutën. Unë, si jurist, duke e njohur edhe Kushtetutën, besoj se kjo do të ishte në nderin e çdo kolegu, sepse sot jemi para një fakti, që, për efekt të një raporti të hartuar nga kolegja Bushka, si relatore e shumicës, Kuvendi shkeli Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Këtë thotë vendimi i Gjykatës Kushtetuese.

E dyta, sinqerisht shqetësohem shumë që zonja Bushka qenka lodhur me të gjitha ato që parashtrou, me studime krahasimore të vendeve të ndryshme, me citime të praktikës së Komisionit të Venecias dhe me analizat e paragrafëve 50 dhe 51. Vetëm te paragrafi 56 nuk shkoi, pra ngeli deri te 54-ra, në një kohë që paragrafi 56 është thelbi për të cilin jemi mbledhur sot. Pastaj u kujtova që nuk kishte asgjë të re në ato që tha zonja Bushka, pasi janë ekzaktësisht parashtrimet që mbrojtësit e Olta Xhaçkës dhe qëndrimi i shumicës ia kanë paraqitur Gjykatës Kushtetuese.

Ne nuk jemi këtu për të komentuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese, por për t'i zbatuar. Nuk ka asnjë ndryshim në qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese sa u takon këtyre rasteve. Historia ka nisur që në vitin 2016, kur Kuvendi refuzoi një mocion të pakicës së kohës për të dërguar në Gjykatën Kushtetuese rastin e mandatit të deputetit Koço Kokëdhima, pa asnjë vendim interpretues të Gjykatës Kushtetuese. Ne e dimë që vendimet interpretuese të Gjykatës Kushtetuese janë normë kushtetuese.

Për të kaluar te rasti konkret, se ne nuk kemi ardhur të bëjmë teori e as të citojmë çfarë ka thënë pakica, por të citojmë çfarë ka thënë shumica dhe çfarë është e detyrueshme për Kuvendin në zbatim të vendimit të shumicës, mua më vjen keq që kolegja ime deputete dhe juriste nuk referoi që, në fakt, Gjykata Kushtetuese ka zgjidhur një konflikt kompetencash dhe i ka dhënë të drejtë pakicës në raport me vendimmarrjen e shumicës. Ky është vendimi i Gjykatës Kushtetuese dhe nuk ka nevojë as të ndryshohet Kushtetuta, as për ta interpretuar atë dhe as për të ndryshuar Rregulloren e Kuvendit. Është e vërtet që ka ndryshuar Rregullorja e Kuvendit, por nuk ka ndryshuar pjesa që rregullon Kuvendi në lidhje me mandatin e deputetit, madje ka një dispozitë konkrete në Rregullore se si trajtohen këto raste. Ka një vendim të Gjykatës Kushtetuese ku thuhet: “Në emër të Republikës së Shqipërisë”, dhe sipas nenit 132 të Kushtetutës vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për zbatim.

Teoritë, doktrinat dhe studimet që mund të na shërbejnë për të mbrojtur doktoraturën apo titujt akademikë, keni bërë mirë që i keni marrë, keni vënë në punë edhe stafin e Kuvendit, por ia keni harxhuar kohën kot, sepse nëse stafi i Kuvendit është angazhuar për të përgatitur raportin që lexuat ju, ku nuk kishte asnjë fjalë se si zbatohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese, keni harxhuar edhe paratë e taksapaguesve kot, se nuk paguhet stafi i Kuvendit për të bërë studime se si të shpëtojme Olta Xhaçkën nga paraqitja në Gjykatës Kushtetuese.

A e kuptoni se sa absurdë jeni më këtë trajtim që i bëni çështjes?! Ah, po, të vinit këtu dhe të thoshit se duhet të shfuqizojmë ligjin e investitorëve strategjikë apo ta ndryshonit dhe të vendosnit një normë atje, që burri i një deputeteje nuk mund të marrë statusin e investitorit strategjik dhe të përfitojë nga statusi i investitorit strategjik, patjetër që po, sepse është në mbrojtje të interesit publik. Por të vish këtu dhe të bësh avokatin e një gjëje që nuk mbrohet, e nderuar kolege, për mua je në cenim të atij betimi që ke bërë ditën e parë të ushtrimit të mandatit. Ne nuk jemi betuar në Kushtetutë për t'i shërbyer Olta Xhaçkës, por për t'u shërbyer qytetarëve të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim nuk sjell efekte në legjislacion. Kryetarja e Kuvendit ka referuar pikën 1, shkronjën “c”, të nenit 87, për shkak se ka zgjidhur një konflikt kompetencash, jo se ka krijuar vakuum apo ka nevojë për plotësim në legjislacion, nuk jemi në atë rast. Kjo është një çështje konkrete individuale dhe ka një mocion me një të dhjetën e anëtarëve të Kuvendit për verifikim të mandatit të një deputeti. Gjykata Kushtetuese ka thënë se mocioni duhet detyrimisht, në përputhje me Kushtetutën, të çohet në Gjykatën Kushtetuese.

Ju ngecët te paragrafi 54, por në fakt thelbi i vendimit është paragrafi 56. Pra, nuk ka nevojë të verifikohet, sepse e ka verifikuar Gjykata Kushtetuese, e cila për rastin konkret ka shqyrtuar provat dhe mocionin. Ajo thotë: “Në rastin konkret Kuvendi duhet të kishte pranuar mocionin e kërkuesit dhe të dërgonte çështjen për shqyrtim në këtë gjykatë, në mënyrë që aspektet e pretenduara si të papajtueshme me mandatin e deputetes Olta Xhaçka t'i nënshtrohen vlerësimit kushtetues, pasi gjatë gjykimit nuk u verifikua asnjë pengesë juridikoformale që mocioni të pengohej nga Kuvendi. Në përfundim gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit janë të bazuara dhe si të tilla duhet të pranohen”. Për këtë arsye ka vendosur zgjidhjen e konfliktit të kompetencave, pra, na ka dhënë të drejtë ne dhe jo juve, sepse keni shkelur Kushtetutën, ndaj Kuvendi duhet t'ia përcjellë rastin Gjykatës Kushtetuese.

Pra, pika 2 ka shfuqizuar vendimin nr. 83 që ka miratuar mosdërgimin në Gjykatë Kushtetuese dhe vendimin nr. 84 që ka rrëzuar raportin tonë për ta dërguar në Gjykatën Kushtetuese. Këtu duhet thënë vetëm një fjali: ndjesë që shkelëm Kushtetutën. Këtë fjali duhet ta thoni ju, sepse është e ndershme, nëse nuk e keni mbrojtur me vetëdije Olta Xhaçkën. Pra, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese nga ju duhet të dilte një fjali: “Të dashur shqiptarë, ju kërkojmë ndjesë që shkelëm Kushtetutën. Ne e interpretojmë gabim, por tani që e ka interpretuar Gjykata Kushtetuese, e nderuara zonja Olta Xhaçka duhet të shkojë të përballet në Gjykatën Kushtetuese”. Gjykata Kushtetuese këtë ka thënë, ndërsa ju bëni teori formale substanciale se paragrafi 19 i vendimit të pakicës ka thënë këtë, po ta lexojmë paragrafin 49, flet për mocionin, ndërsa paragrafi 50 flet për këtë e të tjera. Ne e kemi lexuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese, e cila ka thënë se shumica ka shkelur Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, kaq ka thënë dhe nuk ka asnjë ndryshim të raportit.

E nderuar kolege, 134-a ka qenë e njëjta dispozitë. Në atë çështje Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike e kam përfaqësuar unë. Unë kam qenë me qëndrimin tënd, që një e pesta mund ta vë direkt në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese ka thënë jo, duhet një vendim i Kuvendit. Nëse keni ndryshuar ligjin, siç keni ndryshuar ligjet e reformës, në shkelje të Kushtetutës, është problemi juaj, por vendimi nr. 2 ka vendosur pushimin e gjykimit. Pra, Këshilli i Legjislacionit nuk ka punë me atë vendim, se gjykata ka vendosur pushimin e gjykimit, ne kemi punë me zbatimin e vendimit nr.1. Gjykata ka zgjidhur konfliktin, për ta bërë më të thjeshtë, mes raportit që hartova unë dhe raportit që hartuat ju, zonja Bushka, dhe ka thënë se raporti i hartuar nga pakica duhet të ishte përcjellë në Gjykatën Kushtetuese. Kjo tani është detyrë e Kuvendit, pra të zbatojë vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe të çojë çështjen përpara kësaj gjykate.

Pastaj se si e kemi interpretuar deri më sot atë dispozitë kushtetuese, si mendojmë ne, çfarë ka thënë Komisioni i Venecias, çfarë diskutimesh janë bërë kur është hartuar Kushtetuta, çfarë kanë thënë ekspertët konstitucionalist kur i keni pyetur ju apo çështje të kësaj natyre, ju i keni paraqitur të gjitha, sepse këtu kam parashtrimet që keni bërë në Gjykatën Kushtetuese. Në raportin që ju lexuat janë parashtrimet që i keni çuar në Gjykatën Kushtetuese, e cila nuk ju ka dhënë të drejtë. Ne nuk jemi këtu të ndryshojmë vendimet e Gjykatës Kushtetuese, nuk jemi këtu për të thënë: “në këndvështrimin tim Gjykata ia ka futur kot dhe nuk ka të drejtë”. Kush jemi ne të themi këtë? Ne nuk kemi asnjë tagër për të gjykuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Ne kemi detyrimin kushtetues të zbatojmë nenin 32.

Ju lutem shumë, lërini këto filma e teatro, sepse na keni vonuar shumë. Po mbushet gati një vit që nga qershori i vitit 2022, kur e kemi sjellë dhe tani jemi në prill të vitit 2023, pra po mbushet viti që kur ka nisur kjo gjë. Nuk ka nevojë për teori dhe zvarritje, se nuk e pengoni dot, nderin koleges ia keni bërë me aq sa keni mundur, pra në kundërshtim me Kushtetutën penguat dërgimin raportit në Gjykatë Kushtetuese. Ndërsa tani është shprehur Gjykata Kushtetuese, nuk keni se çfarë të bëni më për këtë çështje. Edhe sikur të hipni dhe të zbrisni 10 herë godinën e Kuvendit, nuk e ndryshoni dot vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Kjo nuk është çështje personale, ju mund të keni miqësi me kolegen tuaj, unë ju mirëkuptoj, por kjo nuk është çështje ushtrimi i përgjegjësisë kushtetuese, ne nuk flasim as si shokë dhe as si miq, por si deputetë të Kuvendit të Shqipërisë. Ne si deputetë dhe si anëtarë të Këshillit të Legjislacionit, duhet të zbatojmë vendimet e Gjykatës Kushtetuese.

Edhe 1 orë që na more, e nderuar kolege, duke folur për çështje që nuk janë për t'u trajtuar këtu, në gjykimin tim është një humbje kohe e secilit prej nesh.

Zonja kryetare, ne duhet menjëherë të procedojmë me kërkesën drejtuar Kryetares së Kuvendit, që në seancën më të afërt plenare Kuvendi i Shqipërisë të vendosë dërgimin e çështjes përkatëse në Gjykatën Kushtetuese.

Unë nuk dua të paragjykoj, qëndrimi është që zonja Xhaçka e ushtron mandatin në kundërshtim me Kushtetutën. Askush nuk ju kërkon të ndryshoni qëndrimin tuaj, ju vazhdoni të pretendoni se ajo nuk e ka shkelur Kushtetutën. Ne kërkojmë që për këtë çështje të shprehet Gjykata Kushtetuese. Ne nuk mund të marrim kompetencat e kësaj gjykate, e kemi thënë edhe në fillim gjatë trajtimit të kësaj çështjeje, pra nuk është kompetencë jona të gjykojmë nëse është apo jo në shkelje kushtetuese, këtë e ka Gjykata Kushtetuese, i vetmi detyrim yni është të dërgojmë këtë çështje në Gjykatën Kushtetues, sepse jemi shumë vonë.

Ne duam të bëjmë një tryezë dhe të ulemi me konstitucionalistë, për të analizuar se çfarë ka thënë Venecia, Këshilli i Europës, si mendoi Sabri Godo dhe Arben Imami kur hartuan Kushtetutën apo çfarë mendojmë ne se si e trajton këtë çështje Gjykata Kushtetuese. Përpara kemi fushatën, ndaj mund ta bëjmë pas fushatës, tani nuk kemi shumë kohë, as ju dhe as ne. Ne mund ta bëjmë për ego profesionale, për kënaqësi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ajo foli dy orë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë do të flas 3 orë, sepse kam kohën e njeriut që para 6 muajsh ju thashë se po shkelni Kushtetutën, ndërsa ju më thatë se ia fusni kot, sepse ne kemi të drejtë. Tani na lini ta shijojmë, sepse Gjykata Kushtetuese nuk ju dha të drejtë juve, por neve. Në vend që të vini me kokën ulur dhe të thoni: “Ju kërkujmë ndjesë se kemi shkelur Kushtetutën”, vini këtu dhe thoni: “Do ta shikojmë njëherë nenin 70, te ky vendimi Gjykata Kushtetuese tha kështu, ndërsa tek ai tjetri ka thënë ashtu, se te paragrafi 19 vendimi i pakicës ka thënë ashtu”. Ju lutem, lëreni teatrin, nuk e mbroni dot!

Unë e kuptoj, se po të ishte një koleg i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike edhe unë do të isha në vështirësi, do të ngrija dorën me vendim politik që të mos shkonte, por kur vjen vendimi i Gjykatës Kushtetuese nuk kam se çfarë t’i bëj më.

Kur t’ju thotë Olta: “Si votuat për ta çuar në Gjykatën Kushtetuese”, do t’i thoni: “Motër, nuk kemi çfarë të bëjmë se na ka thënë Gjykata Kushtetuese”.

Edhe Koço Kokëdhimën e mbrojtët, edhe Valentina Leskajn e mbrojtët...

Ermonela Felaj – Zoti Bardhi, ju lutem mos u fut në meritën e çdo deputeti se je kontradiktor, më mirë thuaj se i takon Gjykatës Kushtetuese dhe merresh vesh.

Gazment Bardhi – Jo, unë po them ta çojmë

Ermonela Felaj – Nëse i takon Gjykatës Kushtetuese...

Gazment Bardhi – Jo, jo, nuk po i hyj meritës. Për atë që keni bërë deri tani nuk i keni hyrë meritës, ju thjeshtë nuk doni ta çoni çështjen të trajtohet në Gjykatë Kushtetutës, kjo është diferenca mes nesh.

Të njëjtën sjellje keni bërë me Koço Kokëdhimën, e penguat procesin 1 vit e gjysmë. Nëse e shikoni se si ka shkuar ajo çështje, edhe ajo është zvarritur me 1 vit e gjysmë, deri sa shkoi në Gjykatë Kushtetuese, e cila ia hoqi mandatin. Të njëjtën gjë bëte edhe me Valentina Leskajn, e zvarritët procesin për 1 vit e gjysmë, por në atë rast Gjykata Kushtetuese nuk ia hoqi mandatin. Pra, ne po kërkujmë që ta çojmë në Gjykatë Kushtetuese, këtë e kemi kërkuar përpara 6 muajsh, ndërsa tani e keni detyrim kushtetues.

Lërimi teoritë se është lodhur Klodi, kishte shkruar 30 faqe dhe nuk po dinte se çfarë po thoshte dhe ku do të dilte, sepse e dinte...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kam edhe disa agreemente.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e kam personale...

Ermonela Felaj – Kjo nuk është një gjë mes dy ish-relatorëve, pra se si u përballën në Këshillin e Rregullores dhe Mandateve dhe se si u përballën në Kuvend, ne kemi për detyrë analizimin e këtyre vendimeve dhe leximin, ndaj...

Gazment Bardhi – Nuk e kisha aty, por e kisha që Klodi ishte lodhur shumë, e cila në fund tha se nuk kam se çfarë të them për këtë rast, ndaj bëni çfarë të doni. Pra mori 3 javë kohë për të lexuar atë që kanë sjellë shërbimet e Kuvendit herën e shkuar. Pra, u zvarrit edhe 3 javë.

Ermonela Felaj – Këto konsiderata nuk janë nga ato konsiderata që i japin mundësi këtij Kuvendi të kuptojë se çfarë ka vendosur Gjykata Kushtetuese. Me gjithë respektin për ju, nuk është kjo një lloj konsiderate. Ne jemi këtu, sepse jemi juristë. Po të marrësh fjalën tuaj dhe ta shikosh se sa për qind keni folur si jurist dhe sa për qind si Gazmend Bardhi politikan, besoj se do të shkante mbi 90 % nga kjo e fundit.

Gazment Bardhi – Patjetër.

Ermonela Felaj – Ndaj ti mund të flasësh edhe si jurist dhe përballemi si juristë me argumente, por jo me komente që i takojnë secilit. Ne nuk jemi mbledhur për një mbledhje moraliteti, se si sillet gjithsecili në raport me Kushtetutën

Gazment Bardhi – Unë nuk po bëj moral. Ti duhet të biesh dakord me mua që një ndjesë...

Ermonela Felaj – Unë do të bie dakord me ty dhe me çdo kënd vetëm nëse dëgjoj argumentin juridik, sepse argumenti profesional është një gjë që më intereson.

Tani, vetë Gjykata Kushtetuese ka pasur debate mes saj, ne kemi vendimmarrje këtu, të cilat edhe pse kanë rënë dakord me pjesën e shumicës janë pjesërisht dakord me arsyetimin. Ne kemi detyrim ta shikojmë edhe dispozitivin, edhe arsyetimin, për të kuptuar se çfarë dhe përse kërkohet në të vërtetë.

Tek e fundit, a do të vendosim një standard? Standardi nuk vlen për nevojën politike të ditës së një subjekti politik. Standardi duhet të jetë i mirëmenduar përpara se të vendoset, sepse duhet të jetë sa më jetëgjatë.

Gazment Bardhi – Standardi e çon gjithmonë në Gjykatë Kushtetuese. Tani më lini ta mbaroj.

Ermonela Felaj – Dhe secilin ta përballë njësoj.

Gazment Bardhi – Unë nuk bëra asnjë moral, sikundër kolegja nuk më keqkupton për atë që thashë, por realisht prisja të thoshte: “Jam betuar në Kushtetutë dhe ju kërkoi ndjesë se kam

shkelur Kushtetutën”. Nëse do të isha unë, do të thosha: “Ju kërkoj ndjesë, se ashtu e lexova Kushtetutën. Gjykata Kushtetuese thotë se e kam shkelur, ndaj ju kërkoj ndjesë, sepse nuk e kam bërë me qëllim”.

Pra, doja të kuptoja nëse e ka bërë apo jo me qëllim. Me këtë që parashtroj sot kuptova se a ka bërë me qëllim. Këtë po shpjegoja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për aspektin profesional dhe argumentin profesional...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Merre fjalën, nuk ka problem...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Ju lutem, të jemi përdorues më të dobishëm të kohës.

Gazment Bardhi – E mbarova.

Gjykata Kushtetuese, edhe për informim e opinionit publik, ka shfuqizuar dy vendime dhe ka zgjidhur konfliktin e kompetencave. Kur zgjidh konfliktin e kompetencave, do të thotë se kush ka të drejtë, shumica apo pakica. Në këtë rast i ka dhënë të drejtë pakicës, pra qëndrimi i pakicës është gjetur i drejtë. Në rastin konkret Kuvendi është i detyruar ta çojë çështjen në Gjykatë Kushtetuese. A biem dakord për këtë?

Atëherë, si çohet në Gjykatën Kushtetuese? Me një kërkesë të këtij Këshilli, siç thotë edhe pika 3 e nenit 87 të Rregullores. Duhet t’i kërkojmë Kryetares së Kuvendit që kjo çështje të përfshihet në rendin e ditës së seancës më të parë plenare. Nuk po e bëja kot parashtrimin, sepse kemi humbur shumë kohë. Kemi humbur edhe 3 javë kohë nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese, ndërkohë që vendimin e kemi lexuar njëlloj, zonja kryetare dhe aty nuk ka asnjë gjë të paqartë, sepse është krejtësisht e qartë. Kuvendi duhet të marrë një vendim që dosja, siç është dorëzuar nga ata që kanë paraqitur mocionin, të përcillet në Gjykatën Kushtetuese. Më pas ne do të mbrojmë në Gjykatë Kushtetuese qëndrimin tonë, avokatët e zonjës Xhaçka do të mbrojnë qëndrimin e saj. Ne do t’i nënshtrohemi vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese, nuk do të vijmë këtu të themi që kishim të drejtë ne, sepse Gjykata Kushtetuese ia ka futur kot. Pra, këtë çështje do ta vendosë Gjykata Kushtetuese.

Detyrimin që kanë, në përputhje me nenin 132 të Kushtetutës, Këshilli i Legjislacioni dhe Kuvendi është të zbatojnë pa asnjë vonesë, pa asnjë sorollatje, pa asnjë zvarritje të mëtejshme dërgimin e kësaj çështje në Gjykatën Kushtetuese.

Nuk kemi shumë për të bërë, sepse Gjykata Kushtetuese e ka zgjidhur konfliktin vetë me dosjen dhe mocionin që ka ardhur, ndaj duhet një vendim i Kuvendit për ta përcjellë formalisht këtë çështje në Gjykatën Kushtetuese.

Sugjerimi ynë është që Këshilli i Legjislacionit t'i drejtohet Kryetares së Kuvendit dhe të kërkojë që kjo çështje të përfshihet në rendin e ditës së seancës më të parë plenare të Kuvendit të Shqipërisë.

Uroj shumë që Kryetarja e Kuvendit të mos e zvarris, sepse edhe ajo e ka zvarritur, e thashë edhe në mbledhjen tjetër, prej muajsh këtë çështje. Ju lutem, respektoni Kushtetutën dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese!

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Fjalën do t'ia jap zonjës Bushka, për faktin se ju e adresuat disa herë në fjalën tuaj, pastaj të gjithë kolegëve për të shprehur mendimet e tyre rreth Gjykatës Kushtetuese.

Dua të risjell edhe një herë në vëmendje të publikut se ne kemi qenë dhe jemi në afat në trajtimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, sepse afati i Kuvendit nis 30 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Ndaj që në momentin që e kemi iniciuar jemi korrekt. Pa u botuar në Fletoren Zyrtare, nuk mund të mblidhej Këshilli i Legjislacionit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është neni 86 i Rregullores për të gjitha rastet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, që hyjnë në rrethin e analizës nga ana e Këshillit të Legjislacionit, ndaj ju lutem, kjo lexohet pastër, drejtë dhe nuk ka nevojë për interpretime të tjera.

Fjalën do t'ia jap zonjës Bushka.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja kryetare!

Zoti Bardhi, ju garantoj se edhe sikur të ishit ju deputeti ndaj të cilit kryhet kjo procedurë, do të kisha të njëjtin qëndrim.

Unë paraqita një relacion me peshën e përgjegjësisë që më jep roli i relatorit për zbatimin e dy vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Unë nuk dëgjova, përveç ironive dhe ofendimeve tuaja në kundërshtim me deontologjinë mes kolegëve, ndonjë argument se përse nuk jeni dakord që çështjet të tilla, si: zbatimi i vendimeve, duke respektuar nenin 70/1 të Kushtetutës, për sa i takon mosdetyrueshmërisë së mandatit të deputetit; sqarimi i procedurave të Kuvendit për këto raste në vijim të zbatimeve të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, se çfarë do të nënkuptojmë me nocion, do të bëjmë debat apo jo, se kështu na thotë Gjykata Kushtetuese në arsyetimin e vet; deri ku do të

shkojë niveli *prima facie*, sepse kemi një praktikë jurisprudence, e cila në vendimet e fundit që jemi duke diskutuar ka trajtime risi dhe së fundmi, a kemi nevojë të ndryshojmë dispozita kushtetuese ligjore apo Rregulloren e Kuvendit për të trajtuar këto?

Të nderuar kolegë, ju kërkoj të dilni nga roli politik në çështjet e Këshillit të Legjislacionit. Sot ne po diskutojmë vendime të Gjykatës Kushtetuese që nuk do të trajtohen për këtë rast, por do t'i shërbejnë praktikës në të ardhmen. Jeni dakord që ta vendosim një herë e mirë që 1/5-a e deputetëve të Kuvendit nuk do të kenë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka një pikëpyetje në lidhje me këtë çështje. A kemi nevojë ta sqarojmë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk po arrij ta kuptoj se ju jeni opozitë dhe duhet të ishit më të shqetësuar se unë për këtë çështje. E para.

Ermonela Felaj – Ju lutem, zoti Bardhi!

Klotilda Bushka – E dyta, kur Kuvendi vendos, me çfarë procedure do ta detyrojnë përsëri të vendosë? A na e jep Rregullorja e Kuvendit këtë mundësi?

Pra, ironia, ofendimi, zhurma dhe zëri i ngritur nuk janë argumente, sepse këto janë shqetësime dhe këto lloj shqetësimesh kanë nevojë të adresohen? Do t'i adresojmë dot ne apo do të duam konsulentë?

Ermonela Felaj – Çfarë është kjo lloj sjelljeje, të lutem!

Klotilda Bushka - Unë mendoj që kemi nevojë për konstitucionalistë. Pesha e përgjegjësisë për vendimin që duhet të marrim nuk na takon vetëm neve, nuk është se jemi të pamaturuar dhe të nxituar, sepse nuk bëhet fjalë për një rast, por bëhet fjalë për praktikën që do të zhvillohet dhe për standardin nga sot e në të ardhmen. Unë ndoshta ju lodha duke folur për gati 1 orë, por të gjitha shqetësimet e mia lidhur me këto çështje jua shpjegova në mënyrë shumë të qartë, për të kuptuar se na duhet një debat i thellë për këto çështje dhe unë jam serioze në këtë pikë.

Po jua them edhe një herë se po të ishit edhe ju zoti Bardhi, unë këtë qëndrim do të kisha, sepse nuk kam ndër mend të mbroj njeri dhe as t'i hedh poshtë dikujt ndonjë meritë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk ju dëgjova në asnjë argument tuajin të kishit një qëndrim profesional në lidhje me këto çështje. Për sa kohë që ju nuk po na ndihmoni t'i sqarojmë këto pikëpyetje dhe për sa kohë këto janë çështje kushtetuese...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prandaj po ju them që ne duhet të marrim një ekspert konstitucionalist që të na sqarojë në lidhje me këto çështje, kaq e thjeshtë është.

Në fund, zonja Felaj, ky është Këshilli i Legjislacionit dhe nuk është forum politik dhe kjo foltore nuk është e partive politike. Këtu nuk bëhet fjalë që të bëjmë beteja për çështjet e ditës, por bëhet fjalë që ne duhet të vendosim disa standarde, të jemi korrekt në atë që zbatojmë dhe të veprojmë me ligj dhe Kushtetutë dhe jo siç na thotë mendja. Unë për vete kisha dhe jua sugjerova, ju kolegë, nëse mendoni ndryshe e diskutojmë, por të gjithë kemi gjykimin dhe anën tonë profesionale për të vendosur. Sugjerimi im është të marrim ekspert konstitucionalist.

Ermonela Felaj – Zoti Bardhi, të lutem, na krijo mundësinë që të flasin të gjithë anëtarët e Këshillit të Legjislacionit të paktën një herë dhe pastaj do ta keni fjalën ju.

Gazment Bardhi – Dy kolegët e mi ma kanë kaluar mua fjalën.

Ermonela Felaj – Jo, ky rregull nuk ekziston në Rregullore.

Gazment Bardhi – Si nuk ekziston?

Ermonela Felaj – Po nuk ekziston.

Gazment Bardhi – Nuk ekziston as rregulli që do të flasin të gjithë dhe pastaj unë.

Ermonela Felaj – Unë do të isha shumë e lumtur që ta zbatoja në këtë rast.

Zonja Gjonaj, a keni ndonjë gjë për të thënë?

Gazment Bardhi – Po ta mbaroj unë së foluri.

Ermonela Felaj – Do t'ju pyes pasi të ketë folur secili nga një herë...

Gazment Bardhi - Po zonja foli dy herë?

Ermonela Felaj – Zonja bëri replikë ndaj asaj që ju thatë.

Gazment Bardhi – Po edhe unë replikë kam.

Ermonela Felaj – Jo, nuk ka replikë mbi replikën.

Gazment Bardhi – Po e kërkova fjalën përpara.

Ermonela Felaj – Kështu thuhet në Rregullore.

Zoti Bardhi, gjatë gjithë fjalës suaj ju iu adresuat zonjës Bushka...

Gazment Bardhi – Jo, nuk iu adresova zonjës Bushka, por iu adresova...

Ermonela Felaj - ...dhe nuk u morët me vendimin dhe argumentet...

Gazment Bardhi – Ta mbaroj fjalën.

Ermonela Felaj – A mund të jeni mirëkuptues të paktën që të gjithë të shfrytëzojnë një herë të drejtën e fjalës...

Gazment Bardhi – Ja ta mbaroj.

Ermonela Felaj - ...dhe pastaj unë prapë do të vij te ju. Pse nuk keni durim?

Gazment Bardhi – Vetëm një fjali, sepse humb argumenti. Për sa kohë që ne po bëjmë një diskutim...

Ermonela Felaj – Zoti Bardhi, ne tek argumenti do të rrimë, sepse nuk kemi marrë asnjë vendim deri tani.

Gazment Bardhi – Vetëm dy fjali.

Ermonela Felaj - Zonjën Bushka e dëgjuam për argumentet e saj si juriste dhe ju për argumentet tuaja si jurist, por ndërkohë gjithsecili që është këtu ka të drejtë të shprehet. Mund të ketë nga ata që nuk duan të shprehen, por kjo nuk do të thotë që për mendimin tënd të shprehem unë, sepse nuk ka kuptim.

Do të shprehësh mendimet e Dhuratës? Dhurata është e pranishme dhe flet vetë për këtë çështje.

Gazment Bardhi – Unë do të flas në emër të kolegëve të opozitës. Kishim një qëndrim nga mazhoranca, do të kemi edhe ne një qëndrim dhe më pas mund t'i kaloni prapë.

Ermonela Felaj – Ju po abuzoni në këtë mënyrë, dakord? Ju nuk po na lejoni, jua them shumë sinqerisht, sepse kjo nuk ju ndihmon as si jurist dhe as si politikan. Ne jemi duke përballur argumentet e njëri-tjetrit me ato njohuri juridike që disponon secili. Të isha në vendin tuaj...

Gazment Bardhi – Kolegia më bëri 3 pyetje, kështu që më duhet t'i jap përgjigje.

Ermonela Felaj – ...do të kisha pasur dëshirë të dëgjoja se çfarë thonë juristët e mazhorancës....

Gazment Bardhi – Do t'i dëgjoj.

Ermonela Felaj – Unë besoj se ju e keni përgjigjen. Zonjës Bushka, ia kthyet përgjigjen.

Gazment Bardhi – Më ka bërë 3 pyetje, të cilat i kam mbajtur shënim.

Ermonela Felaj – Pyetjet nuk ishin për ju, por ishin dilemat që zonja Bushka ka, duke parë vendime të ngjashme të Gjykatës Kushtetuese. Në funksion edhe të përgjigjes së pyetjeve nuk kërkoi përgjigjen tonë, por kërkoi qëndrimin tonë dhe kërkoi që një apo disa ekspertë kushtetues të jenë të pranishëm. Ky ishte qëndrimi i saj për këtë gjë.

Gazment Bardhi – A mund ta jap unë një...

Ermonela Felaj – Zonja Dhurata, në këtë moment, a dëshironi të shprehni ndonjë mendim?

Dhurata Çupi – Po.

Faleminderit, zonja Felaj!

Unë jam plotësisht dakord me atë që tha zoti Bardhi. Ka një vendim të Gjykatës Kushtetuese, mjafton t'i referohemi një vendimi më parë, të cilin mendoj se u relatua nga zonja Gjonaj dhe nuk ka asnjë ndryshim. Në një vendim të Gjykatës Kushtetuese thuhet: “Pranimin e pjesëshëm të kërkesës për shfuqizimin e dy pikave të një dispozite në Kodin Penal”. Për këtë nuk u kërkua ekspert, por u deklarua këtu se vendimi i Gjykatës Kushtetuese është i qartë dhe duhet zbatuar.

Unë mendoj se në të njëjtin pozicion është edhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese, të cilin e relatoi zonja Bushka, që është i prerë, pranimi i kërkesës dhe dërgimi i vendimit të Kuvendit në Gjykatës Kushtetuese për t'u shqyrtuar. Unë nuk mendoj se duhet të botojmë edhe një komentari për këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese, sepse është i qartë. Nëse duam të marrim kohë, në fakt, kjo duket qartë, por nëse duam të jemi seriozë dhe të justifikojmë prezencën në Këshillin e Legjislacionit, të cilit, në fakt, duhet t'i japim autoritetin, kompetencën dhe seriozitetin e duhur, mendoj që nuk duhet të zgjatemi më me këto argumente, por në seancën më të afërt Kuvendi duhet të investojë, të marrë vendimin që kërkon Gjykata Kushtetuese dhe t'ia dërgojmë për shqyrtim. Nuk mendoj se duhet të zgjatemi më tej, as me komente, sepse çdo tentativë për ta zgjatur dhe për ta futur në hullitë e komentareve besoj se do të na kthejë edhe ne në qesharakë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Çupi!

Zonja Gjonaj, dëshironi të jepni mendim?

Etilda Gjonaj – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, unë i qëndroj mendimit të zonjës Bushka, për një arsye, e cila nuk lidhet as me zgjatjen e afatit dhe as me zvarritjen e një procesi. Falënderoj zonjën Çupi që e përmendi, për të cilin unë kërkoja një mendim për t'u rrahur me ekspertët apo me institucionet ligjzbatuese që janë përgjegjëse për Kodin Penal, pra për dy paragrafë që shfuqizoheshin. Në radhë të parë, ne, pavarësisht se jemi juristë, jemi politikanë dhe anëtarë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Zoti Bardhi, nuk ka askush të drejtë më shumë sesa dikush tjetër të thotë bëni ose mendoni kështu siç them unë. Ky është respekti minimal.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne e dëgjuam kolegen tuaj, por nëse ju nuk keni durim të dëgjoni, dilni dhe ejani më pas nëse ju shqetëson kjo gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po harxhoni kot energji duke e ngritur zërin, sepse të njëjtën gjë ne mund ta bëjmë 10-fish, sikurse mund të bëjmë edhe të tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e kuptoj këtë kërcimin tuaj përpjetë përballë diçkaje që po thuhet. Pse hidheni përpjetë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse ju jeni i vendosur dhe nuk dyshoni në argumentin tuaj që është logjikë dhe i bazuar nuk ka asgjë për t'u shqetësuar.

Ju lutem, ta vijojmë rregullisht mbledhjen!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Bardhi, nuk jemi në orën e Edukatës Morale, por jemi në mbledhjen e Këshillit të Legjislacionit. Kolegët, për aq sa munden ta dëgjojnë njëri-tjetrin, nëse keni argumente thuajini, nëse jo dëgjoni argumentet që kolegët kanë dëshirë t'i ndajnë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Bardhi, unë jam këtu për të drejtuar Këshillin e Legjislacionit dhe jo për të ndarë diçka tjetër me ju apo me kolegët tuaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mbledhjen po e drejtoj sipas Rregullores dhe po ndjek rendin e ditës, ndërsa ju nuk po na lejoni që kolegët të shprehin mendimet e tyre.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne e konstatuam që në mbledhjen e parë që ju nuk donit të bënit asnjë lloj analize apo përballje, se për ju gjërat ishin të qarta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka asnjë problem, kështu që mos flisni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Bardhi, nëse jeni i qartë mos flisni, por ama nuk ia hiqni dot askujt të drejtën për të folur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, qetësohuni, mund edhe ta ndërpresim mbledhjen nëse ju nuk qetësoheni dot, por kolegët do të dëgjojnë të gjithë, ky është fakt!

Etilda Gjonaj – Për sa kohë janë caktuar relatorët dhe relatorja ka disa pikëpyetje të ngritura, të cilat pavarësisht se i ka trajtuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Bardhi, mua mos më flisni me ton kërcënues nga karrigia, kështu që më lini ta mbaroj fjalën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pikëpyetjet i ngriti zonja Bushka gjatë relatimit të saj që zgjati gati 1 orë. Për sa kohë janë këto çështje, që kanë nevojë të konsultohen me konstitucionalistë, ne nuk jemi konstitucionalistë, edhe po të kishim njohuri apo edhe nëse mund të ishte dikush prej jush, unë jam e bindur që po të krijoheshin precedentë, do të diskutonim mendimin me ekspertë konstitucionalistë, gjë që nuk krijon zvarritje të procesit.

Zoti Bardhi, të gjitha ato që relatorja tha gjatë relatimit të saj prej gati 1 ore...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E keni edhe në pjesën e relatimit.

Zonja kryetare, për sa kohë që ka këto problematika, kam të njëjtin mendim që kishte edhe relatorja për pjesën e 2 kërkesave.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Zoti Korreshi.

Sajmir Korreshi – E nderuar drejtuese,

Po të ishim në kafe, realisht do të kisha mendimin që mos më jep Olta Xhaçkën se nuk do të na bjerë radha të marrim ndonjë shezlong aty nga plazhi, mirë do të ishte të mos bënim asgjë. Po të ishim në kafe, do të merrnim ndonjë tjetër nga këta të Avokatit të Popullit, se kanë ardhur me shumicë këtu dhe kërkojnë firma, por të arrihet të thuhet këtu në Këshillin e Legjislacionit që

ne nuk marrim vesh se nuk jemi kushtetues, kryetarja dhe nënkryetarja e Komisionit të Ligjeve, si dhe gjithë të tjerët që janë juristë, do të thotë se kemi 3 orë që i biem deficit kot.

Çfarë thuhet këtu? Edhe për Koço Kokëdhimën ta kanë zgjidhur, ata të tjerët që i ranë muzikës së fyellit, të 28-të, tha: O shok...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – A ka mundësi të mos i ndërprisni kolegët? Çfarë është kjo lloj sjelljeje?

Jo, nuk do të marrim konstitucionalistë, por do të dëgjojmë mendimin e zotit Korreshi dhe do të marrim defistë.

Sajmir Korreshi – Dentistë, por për dhëmbët...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Defistë.

Sajmir Korreshi – Jo po marrim gjymistë që i bien gjymit. Nëse jemi të gjithë juristë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ne i biem gjymit me presh.

Edhe ideja se nuk i lexojmë dot ne kaq juristë, ndërkohë që ne miratojnë ligje për 3 milionë persona, atëherë kot sa rrimë këtu. Pra, gjithë këta juristë paskan qenë kot fare, békemi kot rrëk-rrëk në Komisionin e Ligjeve. Të mos e zërthejmë dot këtë?

Mirë do të ishte të mbylleshin kamerat dhe ta shtynim vendim me 6-7 muaj. Në vendim thuhet: sillni letrat atje te ne dhe ta zgjidhim atje. Merrini letrat, hidhini në kurriz, gjeni ndonjë punëtor që merr 400 mijë lekë pa vajtur ora 16:00 ose 16:20 ta sjellë në Gjykatën Kushtetuese dhe ta zgjidhim ne. Po ashtu, 28 deputetët drejtpërdrejtë Gjykatës Kushtetuese t'i thonë që nuk e bëjmë dot atë të 2016-ës, sepse vendimi është i vitit 2016 për kodin, duhet ta dërgojë Kuvendi dhe jo deputetët. Merrini letrat dhe na i sillni, kaq.

Ju mbani qëndrim refuzues, sepse kështu u shpreh edhe zoti Bardhi. Zonja Bushka u shpreh edhe për këtë mandatin që keni interpretuar këtu, të cilit nuk duhet t'i hiqet imuniteti, shkoni mbrojeni atje Olta Xhaçkën. Me disa para dhe disa avokatë të tjerë kushtetues ta mbrojnë, në të kundërt, ishalla nuk e heqin, dhe të bëjmë të gjithë kërkesa për shezlona. Kaq e thjeshtë është puna.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Në fakt, ne vendimet e Gjykatës Kushtetuese për çështjet e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit i kemi, por vetëm nëse i lexon ato, shikon qartësisht se nuk ka asnjë dispozitiv që të jetë i njëjtë me dispozitivin e një vendimi tjetër, sepse janë të gjithë të ndryshëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, janë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pikërisht pra, sepse tha që janë disa vendime, por ato vendime duhen lexuar përpara se të konkludosh.

Fjalën e ka zoti Gogu.

Toni Gogu – Faleminderit, zonja kryetare!

Sa i përket thelbit të çështjes nuk kam ndonjë mendim shtesë apo të ndryshëm nga ajo që u relatua këtu, por kam një vërejtje sa i përket punës sonë si Këshill Legjislacioni. Sipas Rregullores, ne jemi organ këshillimor, i cili jep këshilla dhe mendime. Një organ këshillimor nuk bërtet, nuk imponohet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...dhe nuk mundet asnjëri prej nesh, sado të forta t'i ketë bindjet e veta për një çështje të caktuar, për aq kohë që ne jemi organ këshillimor, diskutojmë dhe pasi mbarojmë diskutimin, relatimin e përcjellim tek organi vendimmarrës.

Kështu që me shumë përvulje dhe respekt do t'u kërkoja kolegëve që të mos e kthejmë një organ të nderur të Kuvendit, i cili ka cilësi këshillimore, në organe që nuk do t'i doja as t'i përmendja, që i kemi parë kohët e fundit dhe që kanë zotëruar jetën publike shqiptare.

Pra, ne jemi këtu të këshillojmë përfaqësuesit e Kuvendit mbi çështjet kushtetuese. Në këtë kuptim do të doja të kontribuoja.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Zoti Bardhi.

Gazment Bardhi – Faleminderit, zonja kryetare!

Ndoshta kolegu ka të drejtë, por irritimi ishte për faktin se realisht kjo çështje ka 1 vit që zvarritet nga shumica dhe, qartësisht, në vend të ndjesës ne morëm sot një propozim tjetër për ta zvarritur edhe më tej këtë çështje. Këtu pastaj kalojmë nga nevoja për një thirrje të caktuar politike te dashja për të penguar zbatimin e Kushtetutës dhe të ligjit. Kjo sigurisht të irriton dhe ne prandaj

e ngremë zërin. Nuk ka asnjë paqartësi te vendimet e Gjykatës Kushtetuese lidhur me mandatin, nuk ka asnjë inkoherencë në qëndrimet e Gjykatës Kushtetuese lidhur me këtë çështje. Gjykata Kushtetuese ka caktuar standardet në një vendim interpretues. Vendimi nr. 7 i vitit 2016 është vendim interpretues dhe ka interpretuar nenin 70 të Kushtetutës. Pra, nuk është çështje individuale, por është vendim interpretues dhe një vendim interpretues i Gjykatës Kushtetuese përbën normë kushtetuese.

Po vij te rasti konkret. Vendimi nr. 1 i vitit 2023 i Gjykatës Kushtetuese është vendim individual, pra trajton një rast konkret dhe ka zgjidhur një konflikt konkret dhe këtu nuk ka asnjë paqartësi. 1/10 e deputetëve kanë paraqitur një mocion për mandatin e deputetes, zonjës Olta Xhaçka, shumica kanë mbajtur qëndrimin që nuk jemi në kushtet e ndalimit të parashikuar nga Kushtetuta e për këtë arsye nuk duhet ta çojmë në Gjykatën Kushtetuese, pakica ka mbajtur qëndrimin që, sipas vendimit nr. 7 të vitit 2016 të Gjykatës Kushtetuese është e detyrueshme që çështja të shkojë në Gjykatën Kushtetuese dhe është kjo e fundit që çmon nëse jemi apo jo në kushte të papajtueshmërisë, në këtë moment për shkak të vendimmarrjes të Kuvendit, ka lindur një konflikt apo mosmarrëveshje kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese, në vendimin numër 1 ka zgjidhur këtë mosmarrëveshje Kushtetuese dhe ka thënë, dhe këtu nuk ka nevojë për të marrë ne ekspertë të jashtëm për ta lexuar, sepse dimë ta lexojmë vetë, nëse nuk duam të bëjmë teatër dhe nuk duam ta zvarrisim; Gjykata Kushtetuese ka thënë se shumica nuk ka të drejtë, ka të drejtë pakica. Kuvendi do të duhet ta përcjellë çështjen në Gjykatën Kushtetuese. A ka thënë këtë vendimi? Çfarë ka këtu për paqartësi? Është e shkruar e zeza mbi të bardhë. Çfarë duam ne tani, të marrim ekspertë të na lexojë këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese?! Doni ta lexojmë me zë? E lexojmë nga paragrafi i parë deri te i fundit dhe ndalemi te çdo paragraf për çfarë nuk kuptojmë. Unë jua thashë në parashtrimin fillestar, edhe unë kam qenë me qëndrimin (shkoni dhe shikojeni), që në përputhje me nenin 134 të Kushtetutës, kur Kuvendi pengonte mocionin, 1/5 t'i drejtohej drejtpërdrejt për mandatin e deputetit Gjykatës Kushtetuese. E ka rrëzuar Gjykata Kushtetuese, e ka bërë atë interpretim dhe e ka vendosur atë standard. Nuk ka ligj që mund të ketë fuqi mbi vendimet e Gjykatës Kushtetuese, sepse vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë praktikisht normë kushtetuese, kanë të njëjtën fuqi, siç kanë edhe normat kushtetuese. Mes Kushtetutës dhe ligjit, do të zbatosh Kushtetutën; këtë ka thënë edhe në vendimmarrjen e fundit Gjykata Kushtetuese. A ka nevojë për diskutim, hajdeni të diskutojmë, por

do të zbatosh vendimin e Gjykatës Kushtetuese në çështjen konkrete. Prandaj janë vendime individuale, kanë pasur si subjekt, zonja Bushka, si subjekt...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gazment Bardhi – Sepse po bën muhabet dhe më tërheq vëmendjen,

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk flisja, nuk bëja muhabet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si subjekt të interesuar ka pasur deputeten Olta Xhaçka, pra është vendim individual, çështje konkrete dhe ka dhënë zgjidhje konkrete. Nuk jemi këtu në një vendim që ka interpretuar legjislacionin apo ka marrë në shqyrtim një normë të caktuar. Jo, është çështje individuale, lidhet me mandatin parlamentar të një deputeti të Kuvendit të Shqipërisë. Gjykata Kushtetuese ka thënë që shumica ka shkelur Kushtetutën, duhet ta sjellë dosjen në Gjykatën Kushtetuese.

Në zbatim të këtij vendimi dhe në respekt të Gjykatës Kushtetuese, vendimeve të saj, nenit 132 të Kushtetutës, që flet për efektin e detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, kemi vetëm një detyrim në përputhje me pikën 3 të nenit 37, që t’i themi Kryetares së Kuvendit: jemi njohur me vendimin e zgjidhjes të kompetencës, vendimi numër 1 të vitit 2023. Sipas atij vendimi pakica ka pasur të drejtë, jo shumica, Kuvendi do të duhet të vendosë për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese. Ju lutem, do të duhet t’i themi ne, në zbatim të këtij vendimi, në seancën më të parë parlamentare, të përfshihet si pikë e rendit të ditës projektvendimi për dërgimin e mocionit të 1/10-ës së deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimin e mandatit të deputetes, zonjës Olta Xhaçka, për shqyrtim dhe vendimmarrje në Gjykatën Kushtetuese. Dhe ne e kemi zbatuar këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese. Për çdo çështje tjetër pastaj, hajdeni të ulemi, ngremë grupe pune për çfarë keni nevojë për të pyetur, e për çfarë keni paqartësi për këtë, dhe për dhjetëra çështje të tjera Kushtetuese po të doni, bëjmë edhe një komision për rishikimin e Kushtetutës, madje ta bëjmë nga neni 1 deri të neni i fundit, por kjo lloj veprimtarie parlamentare nuk ka lidhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese është çështje konkrete, rast konkret, ka dhënë zgjidhje konkrete. Nuk mund të pengoni dot zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, nuk mund ta zvarrisni akoma më shumë, dhe, më vjen keq, por është rast i pashpresë, merrni çfarë eksperti të

doni, nuk ka lidhje me këtë vendim. Ekspertin mund ta merrni për çfarëdolloj çështjeje, por ky vendim ka vetëm një detyrim: dosjen e Olta Xhaçkës ta çoni në Gjykatën Kushtetuese.

Faleminderit.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Bardhi!

Të paktën biem dakord me këtë pjesën e fundit, kur thatë: merrni çfarëdolloj eksperti. Po, mund të marrim çfarëdolloj eksperti, por kjo nuk do të thotë që për çështjen do të vendosi eksperti, do të vendosim vetë ne, dhe do të vendosë Kuvendi sipas bindjes që do të krijohet mbi bazën e argumenteve dhe kundër argumenteve që do të dëgjohen.

Megjithatë, unë po shpreh në këtë Këshill Legjislativ mendimin tim, si juriste, të cilin do ta kisha ndarë shumë thjesht, me ju po që po, por me këdo student të Fakultetit të Drejtësisë, nëse do të kishte interesin të kuptonte rreth vendimeve të ngjashme të Gjykatës Kushtetuese, pra që flasin për rastin e papajtueshmërisë që lind nga parashikimi i nenit 73 të Kushtetutës dhe për të cilin Gjykata Kushtetuese ka ruajtur në mënyrë konstante qëndrimin që duhet të mbetet objekt i gjykimit të saj dhe jo i Kuvendit të Shqipërisë.

Në fakt, janë disa vendime, të cilat duhen lexuar, besoj unë, nga secili, konkretisht vendimet: vendimi numër 1 i Gjykatës Kushtetuese, për të cilin ne jemi mbledhur; vendimi numër 7 i vitit 2016 i Gjykatës Kushtetuese, vendimi numër 72 i vitit 2016 po i Gjykatës Kushtetuese dhe vendimi numër 93 i vitit 2016. Është kjo jurisprudencë, e cila është krijuar në vite nga Gjykata Kushtetuese dhe besoj se duhet marrë seriozisht në analizë nga ana jonë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, patjetër, por kemi dhe ne të drejtën dhe detyrimin, sipas Rregullores së Kuvendit, t'i shqyrtojmë, t'i analizojmë dhe të mbajmë qëndrime përkatëse.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ligjvënësi në këtë vend është Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, nuk është Gjykata Kushtetuese apo ndonjë gjykatë tjetër. Ne na është deleguar sovraniteti nga populli dhe kjo nuk ka ndodhur në ndonjë lloj institucioni tjetër, prandaj edhe çështja bëhet pak më delikate dhe unë mendoj që qëndrimet duhet të jenë të natyrës të balancuar, në kuptimin që realisht të referojmë pjesë nga këto vendime të Gjykatës Kushtetuese.

Pyetja e parë, që do të shtroja unë sikur të isha një juriste e sapodalë nga bankat e Fakultetit të Drejtësisë është: nëse Kuvendi e ka detyrimin automatik që në rastin e paraqitjes së një mocioni,

për një rast të tillë, me një objekt të tillë nga 1/5-ta, Kuvendi e dërgon automatikisht, pse duhet vendimmarrja e Kuvendit?

Së dyti: çfarë e ka penguar Gjykatën Kushtetuese në dispozitiv të thotë (siç e ka thënë): 1. pranimin e kërkesës; 2. zgjidhjen e konfliktit të mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet Kuvendit të Shqipërisë dhe subjektit kushtetues në konflikt, jo më pak se 1/10-ta e deputetëve; 3. shfuqizimin e vendimeve numër 83 dhe 84 të Kuvendit të Shqipërisë si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Kaq. Edhe po ta lexosh fjalë për fjalë dhe po të duash ta interpretosh fjalë për fjalë, shfuqizimi i këtyre dy vendimeve të Kuvendit, na kthen në pikën zero, na kthen te Këshilli i Rregullores dhe Mandateve, që po diskutonte për mocionin tuaj lidhur me papajtueshmërinë e mandatit të deputetes Olta Xhaçka, dhe na kthen aty ku ende Kuvendi nuk kishte marrë vendimin, sepse nuk procedohet automatikisht dhe Gjykata Kushtetuese e ka thënë prapë këtë gjë, e ka thënë në paragrafin 58, në mos gaboj, ku shkruhet se Gjykata rithekson se në zbatim të nenit 70 pika 4 e Kushtetutës, 1/10-ta e deputetëve të Kuvendit ka të drejtë të paraqesë mocion për konstatimin e papajtueshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetit, ndërsa vendimmarrja (*ndërprerje regjistrimi*) për t'u shprehur për themelin e çështjes, për sa kohë pa një vendim të këtij organi, gjykata nuk mund të shqyrtojë kërkesa të tilla.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dhe ma do mendoja që askush këtu nuk mund të thotë që Kuvendi angazhon vendime formaliste, sepse nuk ka një rast të tillë, sepse Kuvendi vendimmarrjen e bazon në debat, dhe mbi bazën e debatit merr dhe vendime përkatëse. Lirinë e debatit që ka Kuvendi i Shqipërisë, nuk mund ta prekë askush, asnjë lloj vendimi i Gjykatës Kushtetuese. Unë personalisht, si juriste, kam rezerva për atë që ju sapo shprehët nëse kanë vendimet e Gjykatës Kushtetues fuqinë e ligjit apo Kushtetutës, Kushtetuta flet për fuqinë e ligjit, jo fuqinë e Kushtetutës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, por është ligj i cilësuar dhe përveç ligjit të cilësuar kemi dhe ligje të miratuar me shumicë të thjeshtë. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese nuk është e ndaluar, por këto sigurisht janë rrethana të jashtëzakonshme, dhe kërkojnë të angazhojnë edhe një mendim juridik tejet të kualifikuar, shumë shkencor, që Gjykata Kushtetuese të ndryshojë dhe vendimmarrjen e vet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pika e fundit që kam, unë e dëgjova me shumë vëmendje zonjën Bushka dhe, pa dyshim, duke qenë se ka qenë dhe relatores as nuk e vendos në diskutim që është edhe më e thelluar në

argumentet dhe në pyetjet që ngritit, por unë nga një lexim i vendimit të fundit të Gjykatës Kushtetuese, i ballafaquar me lexime të vendimeve të mëparshme të Gjykatës Kushtetuese për këto çështje ka një diskutim: Gjykata Kushtetuese rast pas rasti ka marrë në referencë 2 nene të Kushtetutës, ka marrë nenin 73, por ka marrë dhe nenin që bën fjalë për komisionet hetimore. Ju lutem, zonja Bushka, më jepni pak Kushtetutën, se nuk dua të gaboj.

Në rastin e nenit 77...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ju lutem, është në përmbajtje dhe arsyetimi është i detyruar për ta lexuar dhe unë po parashtroj atë që mua personalisht më krijon dilemë, më krijon dykuptimësi, (këtë të drejtë që unë ta mendoj kështu, nuk ma heq askush), pra po lexoj: “Kuvendi ka të drejtë dhe më kërkesë të 1/4 të të gjithë anëtarëve të tij, është i detyruar të caktojë komision hetimi për të shqyrtuar një çështje të veçantë” dhe shumicën e 1/4 e ka konsideruar në disa vendime si pushtet të pakicës mbi shumicën kur ka arsyetuar në drejtim të detyrimit që ka Kuvendi për ngritjen e komisionit hetimor, por, nga ana tjetër, Gjykata Kushtetuese, në të gjithë vendimmarrjet e saj për komisionet hetimore ka thënë që Kuvendi mund ta rrëzojë, sepse kërkesa mund të jetë haptazi antikushtetuese dhe ku duket kjo, tek objekti; nëse objekti cenon, fjala vjen, parimin e ndarjes së pushteteve, sigurisht që Kuvendi ka gjithë të drejtën Kushtetuese dhe ligjore ta rrëzojë një komision të tillë hetimor. Dhe kjo është arsyeja se përse disa komisione hetimore, të cilat Kuvendi nuk i ka ngritur, Gjykata Kushtetuese nuk e ka gjetur vendimmarrjen e Kuvendit të pa bazuar në ligj dhe në Kushtetutë.

Tani kjo është një shumicë e afirmuar, shumica që e vë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese është shumica prej 1/5 dhe ajo është le të themi një lloj pushteti prapë i pakicës mbi shumicën, është një shumicë e riafirmuar me ndryshimet që janë bërë në Kushtetutë, por të mos harrojmë, edhe në ligjin për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, 1/5-ta e vendos në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Po 1/10-ta, a e vendos në lëvizje automatikisht Gjykatën Kushtetuese?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk e vë në lëvizje, sepse duhet të kalojë nëpërmjet Kuvendit. Ka thënë po, Gjykata Kushtetuese.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të thotë duhet të shkosh në Kuvend dhe pa vendimmarrjen e Kuvendit unë nuk vihem në lëvizje. Tani, më falni, unë nuk po përpiqem të vendos pikën dhe të dal mbi Gjykatën Kushtetuese.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë po përpiqem t'ju vendos juve të gjithëve përpara pikëpyetjeve që mua më krijohen në këto momente, për të cilat, përpara se t'i shpreh mendimin tim Kuvendit të Shqipërisë, nëse ai do të kërkonte mendimin tim, siç ka kërkuar mendimin e gjithsecilit nga ju, unë do të doja të dëgjoja dikë më të thelluar në të drejtën kushtetuese, për të më dhënë përgjigje për këto pyetje, për të kuptuar që paska më shumë se një pushtet të pakicës mbi shumicën, nuk është vetëm 1/4-ta nuk është vetëm 1/5-ta, por është dhe 1/10-ta. Me këtë, më fal, por nuk bie dot dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse kjo nuk është trajtuar në asnjë vendim të mëparshëm të Gjykatës Kushtetuese, edhe në vendimin për të cilin po flasim, nuk është objekti ai për të cilin jemi drejtuar nëse është apo nuk është; dhe çfarë është më logjike është që ka kërkuar. Po të ishte se afirmonte këtë që thoni ju, Gjykata Kushtetues mbas kërkesës së parë tuajën hynte në shqyrtimin e thelbit të çështjes së deputetëve dhe thoshte ka konflikt apo nuk ka konflikt papajtueshmërie.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sigurisht pra, do vendim të Kuvendit dhe, që ky vendim i Kuvendit të jetë një qëndrim jo thjesht i shumicës, që identifikohet me mazhorancën, por i një shumice që arsyeton dhe analizon vendimmarrjen dhe është e interesuar të marrë mendimin më të kualifikuar në fushë, unë kështu mendoj se duhet të jetë ky vendim. Sepse, të marrësh vendim sa për në letër, unë besoj se nuk është në respektin e Kuvendit, as në respektin e atyre që na kanë zgjedhur ne këtu që të diskutojmë dhe të flasim. Është shumë e thjeshtë, në fakt, t'i bëjmë mbledhjet për 1 orë, sikurse mund t'i bëjmë edhe për disa ditë. Unë mendoj që ne seriozitetin e shprehim me ato që flasim dhe me ato që debatojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por nuk po keni respekt, sepse unë ju dëgjoja të gjithëve me qetësi, ndërsa ju nuk e bëtë këtë me kolegët e mazhorancës, dhe nuk më duket që është korrekte, jemi juristë. Asnjëri nga ne nuk ka yll në ballë, zoti Bardhi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju po bëni teatër.

Asnjëri nga ne nuk ka yll në ballë zoti Bardhi. Ne kemi të drejtë të shprehemi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër...

Nxora 55-ën, por 56-ta paraprihet nga 55-a, dhe te 56-ta thuhet se vërtet rasti i shqyrtimit të papajtueshmërisë së mandatit të deputetit për 73 i takon Gjykatës Kushtetuese. Ama më përpara më ka thënë se unë nuk i hyj fare këtij rasti dhe nuk të them asnjë konsideratë në këtë rast nëse Kuvendi nuk ma sjell, nëse Kuvendi nuk merr vendim. Dhe me këtë mbledhje ne duam as më shumë as më pak, por t'i lehtësojmë vendimmarrjen Kuvendit. Kaq është e thjeshtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Bardhi, ky është leximi im, ky është qëndrimi im, që nuk u bazua në ndonjë nen të statutit të Partisë Socialiste, por u bazua thjesht dhe vetëm në atë që Gjykata Kushtetuese ka thënë në vite. Dhe unë atë referova, numra vendimesh dhe paragrafë.

Kështu që, pasi dëgjova të gjithë kolegët, meqenëse shumica e kolegëve të këtij Këshilli Legjislativ mendojnë se duhet të thërrasim një ose dy ekspertë të kushtetueses, apo sa është e nevojshme, do të marrim përgjigjen e pyetjeve dhe pastaj do t'i formulojmë.

Gazment Bardhi – Ju jeni mësuar të vidhni taksat e shqiptarëve.

Ermonela Felaj - Zonja Bushka, a keni ndonjë propozim për emrin e ekspertit ose ekspertëve.

Gazment Bardhi - Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për t'u zbatuar. Nuk ka nevojë për ekspertë. Unë e kuptoj që ju edhe në Gjykatën Kushtetuese ftoni ekspertë dhe i paguani me taksat tona.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Kjo është shkruar në vitin 1998, kur forca politike që ju përfaqësoni nuk e votonte këtë gjë. Këtë nuk ka nevojë ta përsërisësh.

Gazment Bardhi – Jo zonjë, ky është rast individual.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, çfarë të bëjë brenda ditës së nesërme?

Ermonela Felaj – Brenda ditës së nesërme të bëjë me dije propozimin e saj për ekspertë edhe juve, nëse së bashku...

Gazment Bardhi – Për çfarë duhet eksperti?

Ermonela Felaj – Për t'iu dhënë përgjigje pyetjeve dhe dilemave që ne kemi.

Gazment Bardhi – Po cilat dilema?

Ermonela Felaj – Shiko ta dëgjosh, është e gjitha e regjistruar, prandaj ju ftoj ta dëgjoni, dhe jam e bindur që do t'i kuptoni të gjitha.

Gazment Bardhi –Kuvendi duhej të kishte pranuar mocionin e kërkuesit dhe ta dërgonte në Gjykatën Kushtetuese. Merrni ekspert burrin e Olta Xhaçkës, të vijë këtu dhe të na tregojë si do të fitojë para nga një pasuri publike.

Ermonela Felaj – Faleminderit kolegë për prezencën edhe për kontributet tuaja. Brenda ditës së nesërme bëhen publike kur do të jetë mbledhja e radhës dhe kush do të jenë ekspertët, së bashku me pyetjet që ka relatorja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, ndërpriteni regjistrimin e mëtejshëm, sepse mbledhja përfundoi!

MBYLLET MBLEDHJA